



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_/\_\_/2024

**RAPORT AUDITIMI PERFORMANCE**

“Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike”



**TIRANË 2024**

## P Ë R M B A J T J A

<b>1.PËRMBLEDHJE .....</b>	<b>4</b>
<b>2.PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT .....</b>	<b>5</b>
2.1 Konteksti i problemit social .....	5
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës .....	6
<b>3. SUBJEKTET NËN AUDITIM.....</b>	<b>7</b>
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim.....	7
3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim .....	8
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	9
3.4 Pësia në buxhet.....	9
3.5 Përkufizimet dhe terminologjia.....	10
3.6 Skema e analizës së programit auditues .....	11
3.7 Feedback-u i subjektit përgjatë auditimit .....	12
<b>4. DETAJET E AUDITIMIT .....</b>	<b>12</b>
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit .....	12
4.2 Objektivi i auditimit .....	14
4.3 Pyetjet e auditimit .....	15
4.4 Fushëveprimi i auditimit .....	16
<b>5. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE .....</b>	<b>17</b>

✂ **LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>BE</b>	<b>Bashkim Evropian</b>
<b>GCF</b>	Fondi i Gjelbër për Klimën
<b>GNP</b>	Grupi Ndërministror i Punës
<b>INDC</b>	Kontributi i Kombëtar i Pikësnyuar
<b>INSTAT</b>	Instituti Shqiptar i Statistikave
<b>INTOSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>INTOSAI WGEA</b>	Grupi i Punës i INTOSAI-t në kuadër të Auditimeve Mjedisore
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Jashtëm Publik
<b>IPA</b>	Instrumenti për Asistencën para-Anëtarësim
<b>IPCC</b>	Panel Ndërkombëtar për Ndryshimet Klimatike
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>KLSH</b>	Kontrrolli i Lartë i Shtetit
<b>MRV</b>	Monitorimi Raportimi Verifikimi
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>NAP</b>	Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike
<b>NDC</b>	Kontributit Kombëtar të Përcaktuar
<b>NK</b>	Ndryshimet klimatike
<b>AKP</b>	Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar
<b>OJF</b>	Organizatë Jo-Fitimprurëse
<b>PNK</b>	Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
<b>SMNS</b>	Strategjia Mjedisore Nder sektoriale
<b>UNFCCC</b>	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## 1. PËRMBLEDHJE

Ndryshimet Klimatike përfaqësojnë një fenomen shumë shqetësues si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar e ndërkombëtar. Përshtatja dhe kufizimi ndaj ndryshimeve klimatike është njëkohësisht edhe një nga 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 2015.


Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria ka hyrë në epokën e re të procesit të politikave klimatike ndërkombëtare, ku të gjitha palët synojnë në mënyrë kolektive ta mbajnë rritjen e temperaturës globale në 2°C mbi nivelin paraindustrial.

Sa më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, ka hartuar Strategjinë e Përgjithshme Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën.

Në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, MTM ka hartuar Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, në kuadrin e Grupit Ndërmjësor të Punës së Ndryshimeve Klimatike. NAP-i ofron një kuadër për integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorët e synuar, si dhe vendos një kuadër zbatimi kryesisht, nëpërmjet veprimeve prioritare të mbështetura nëpërmjet mekanizmave mundësues, si buxheti përkatës, informimi dhe përfshirja, zhvillimi i kapaciteteve dhe monitorimi. Ai mund të kuptohet si një dokument “ombrellë” dhe jo si një plan operativ i hollësishëm që përcakton të gjitha veprimet e nevojshme për një proces të suksesshëm përshtatjeje në vend.

Për rrjedhojë, auditimi me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e implementimit të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Në këtë mënyrë u synua të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektiv i eficiencës dhe efektivitetit të institucioneve të përfshira, në drejtim të implementimit të objektivave të përcaktuara nga NAP dhe rritjes së kapaciteteve institucionale.

Fig nr. 1: Objektivat e Zbatimit të Mekanizmit të Marrëveshjes së Parisit



Burimi: World Resources Institute/ Përpunoi: Grupi i Auditimit

Sa më sipër, këtë projekt auditimi u vlerësua:

- Efektiviteti i implementimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të NAP;

- Efektiviteti i menaxhimit të fondeve për veprimet prioritare të ndërmarra mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Eficienca e strukturave të ngritura me qëllim zbatimin e NAP.

Në përfundim, pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi arriti në këtë mesazh auditimi:

Gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për nxitjen e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon marrjen e masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, MTM nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e NAP.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit lidhur me ndryshimet klimatike në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim, është e rëndësishme që MTM të marrë masa, me qëllim që procesi i NAP të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimave në mënyrë periodike.

Sa më sipër, në **kreun 5** të këtij projekti auditues “*Shtjellimi i Pyetjeve Audituese*”, janë trajtuar të gjitha problematikat e konstatuara në mënyrë të hollësishme, duke gjeneruar rekomandimet përkatëse për secilën prej tyre, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit dhe efektivitetit të skemës në garantimin e të drejtave të qytetarëve.

## 2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

### 2.1 Konteksti i problemit social

*“Të gjithë ne e konsiderojmë planetin tonë në kushte optimale, derisa vëmë re koston njerëzore të degradimit të tij. Pasiguria ushqimore, shëndetësore, njerëzore, shoqërore e shtetërore që ka ardhur dhe do vazhdojë të vijë si rezultat i ndryshimeve klimatike është pasoja e veprimeve dhe mosveprimeve tona si individë, korporata dhe shtete”.<sup>1</sup>*

Agnes Callamard - Sekretare e Përgjithshme e Amnesty International

Ndryshimet Klimatike përfaqësojnë një fenomen shumë shqetësues si në nivel lokal, kombëtar, ndërkombëtar ashtu edhe për botën e gjallë dhe atë bimore. Ato përfshijnë jo vetëm rritjen e temperaturave, por edhe ngjarjet ekstreme të motit, rritjen e nivelit të detit, zhvendosjen e popullatave dhe habitateve të kafshëve të egra.

Për shekuj me radhë, situata klimatike e planetit tonë ka qenë e përcaktuar dhe ndikohej më shumti nga faktorë natyrorë. Ndryshimet klimatike zhvilloheshin brenda ligjeve të natyrës dhe ndiqnin rrjedhën e përcaktuar prej tyre. Gjatë dekadave të fundit janë konstatuar një numër i konsiderueshëm ndryshimesh që vijnë si rezultat i aktiviteteve njerëzore si për shembull nga industritë e mëdha emetuese të dioksidit të karbonit.<sup>2</sup> Për të fuqizuar jetën tonë moderne njerëzimi ka sakrifikuar mjedisin dhe mënyra sesi natyra po ja kthen duket se ka kosto tepër të larta jo vetëm financiare por edhe shëndetësore. Ndryshimi i klimës me ritme të shpejta po e bën të vështirë përshtatjen e gjallesave me temperaturat tepër të larta apo tepër të ulëta.

Përshtatja dhe kufizimi ndaj ndryshimeve klimatike është njëkohësisht edhe një nga 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 2015. Misioni i këtij qëllimi, i cili parashikohet në agjendën 2030 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, është marrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij. Në këtë

<sup>1</sup> [https://milieucontact.org/bota-ne-vorbullen-e-ndryshimeve-klimatike/;](https://milieucontact.org/bota-ne-vorbullen-e-ndryshimeve-klimatike/)

<sup>2</sup> <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/19897.pdf;fq 5>


kontekst, shteti është aktori kryesor që duhet të veprojë për ndërmarrjen e hapave të menjëhershëm për të ndryshuar kursin e politikave për sa i përket sferës së mjedisit.

Lidhur me këtë fakt, në raportin e vitit 2021, Grupi Ndërqeveritar për Ndryshimet Klimatike (IPCC) tha se reduktimet e forta dhe të qëndrueshme në emetimet e dioksidit të karbonit dhe gazeve të tjera serë, mund të përmirësojnë cilësinë e ajrit dhe brenda 20-30 viteve temperaturat globale mund të stabilizohen. Për rrjedhojë, në Konferencën e 21-të të Parisit për Ndryshimet Klimatike (COP21), pas 20 vjet negociatash, vendet nënshkruese të Konventës Kornizë të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) arritën një marrëveshje për të luftuar ndryshimet klimatike.<sup>3</sup>

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit,<sup>4</sup> Shqipëria ka hyrë në epokën e re të procesit të politikave klimatike ndërkombëtare, ku të gjitha palët synojnë në mënyrë kolektive ta mbajnë rritjen e temperaturës globale në 2°C mbi nivelin paraindustrial.

Sa më sipër, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka hartuar Strategjinë e Përgjithshme Kombëtare të Ndryshimeve Klimatike për të mbështetur zbatimin e legjislacionit të BE-së për mjedisin dhe klimën, duke synuar forcimin e koordinimit ndërsektorial në Shqipëri për masa mbi klimën, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Tabela nr.1: Të dhëna statistikore për Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike



Burimi: Web UNFCCC/ Përpunoi: Grupi i Auditimit

Pjesë integrale e kësaj strategjie është Plani Kombëtar i Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Plani kombëtar i përshtatjes është krijuar në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, nën udhëheqjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit (MTM). NAP është një proces afatgjatë, i cili ofron një kuadër për integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorët e synuar si dhe vendos një kuadër zbatimi kryesisht, nëpërmjet veprimeve prioritare të mbështetura nëpërmjet mekanizmave mundësues, si buxheti përkatës, informimi dhe përfshirja, zhvillimi i kapaciteteve dhe monitorimi. Ky projekt auditues u zhvillua në kuadër të auditimit të përbashkët global mbi “Veprimet e Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike” të ideuar nga IDI dhe INTOSAI WGEA.

## 2.2 Rëndësia e auditimit të performancës

Auditimi i performancës është një shqyrtim i pavarur, objektiv dhe i besueshëm i faktit nëse sipërmarrjet, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet dhe organizatat qeveritare po veprojnë në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, dhe nëse ekziston mundësia për përmirësim të mëtejshëm. Kontrolli i Lartë i Shtetit e ka vendosur auditimin e performancës si një nga shtyllat moderne të zhvillimit institucional. Në Planin Strategjik 2023-2027, KLSH e ndërton misionin e vet si institucion i pavarur kushtetues, duke qenë partner strategjik i Kuvendit, i qytetarit shqiptar dhe palëve të interesit, duke i informuar në mënyrë të vazhdueshme, të paanshme dhe të plotë, mbi përgjegjshmërinë që qeveria dhe entet publike tregojnë në përdorimin e kontributit të

<sup>3</sup><https://www.bidizelen.org/sq/marreveshja-e-parisit-a-mundet-qe-nje-dokument-te-na-shpetoje-nga-ndryshimet-klimatike/>;

<sup>4</sup> Nju-Jork, 22 prill 2016;



taksapaguesve shqiptarë e duke kontribuar në përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet luftës kundër korrupsionit.

Synimi i KLSH-së në auditimin e performancës është përmirësimi i eficiencës dhe efektivitetit në shërbimet publike që i ofrohen taksapaguesit shqiptar, duke ekonomizuar njëkohësisht përdorimin e fondeve publike. Informimi i publikut dhe i Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me përdorimin e burimeve me efektivitet, eficiencë dhe economicitet, nga pushteti qendror dhe lokal e nga njësi të tjera publike, si dhe nxitja e përgjegjshmërisë në të gjithë sektorin publik, në përputhje me direktivat e praktikave me të mira të BE-së dhe me standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, duke kontribuar kështu në mirë qeverisje.

Në përfundim, në linjë edhe me rekomandimet e Progres Raportit 2022 dhe Strategjinë institucionale 2023-2027, auditimi i performancës synon parandalimin përmes këshillimit, përpara ndëshkimit përmes penalizimit.

### 3. SUBJEKTET NËN AUDITIM

#### 3.1 Hyrje në subjektet nën auditim

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka për mision hartimin dhe zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, zhvillimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, etj. Për sa i përket sektorit të mjedisit, ky institucion ushtron veprimtarinë e tij në drejtim të hartimit të politikave, standardeve të trajtimit të mbetjeve dhe të efektit të tyre në mjedis, cilësisë së ajrit, ndryshimeve klimatike dhe monitorimit të treguesve të mjedisit, vlerësimin e ndikimit në mjedis, etj.

Në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, MTM ka hartuar Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP) në bashkëpunim të ngushtë me ministritë e linjës, në kuadrin e Grupit Ndërmnistror të Punës së Ndryshimeve Klimatike, përgjatë viteve 2015- 2016. NAP-i ofron një kuadër për integrimin e ndryshimeve klimatike në sektorët e synuar, si dhe vendos një kuadër zbatimi kryesisht, nëpërmjet veprimeve prioritare të mbështetura nëpërmjet mekanizmave mundësues, si buxheti përkatës, informimi dhe përfshirja, zhvillimi i kapaciteteve dhe monitorimi. Ai mund të kuptohet si një dokument “ombrellë” dhe jo si një plan operativ i hollësishëm që përcakton të gjitha veprimet e nevojshme për një proces të suksesshëm përshtatjeje në vend<sup>5</sup>. Argumentimi për këtë parim vjen nga njohuria se veprimet e përshtatjes duhet të integrohen në planet dhe politikat e ndryshme sektoriale dhe të zhvillimit në vend dhe duhet të përcaktohen në kuadër të tyre.

Struktura përgjegjëse në Ministri në lidhje me temën në fokus është Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike (DNK), në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit. Organigrama e pjesshme e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit është paraqitur më poshtë:

Figura nr. 1: Organigrama e pjesshme e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit




*Burimi: MTM/ Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Problemet e lidhura me ndryshimet klimatike janë komplekse dhe rrjedhimisht kërkojnë bashkëpunim të shëndoshë ndërinstucional për arritjen e objektivave. Për shembull, raportimet kombëtare për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike bëhen nga një grup pune ndërministror (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike). Ministritë e linjës angazhojnë një ekspert të brendshëm, i cili shërben si pikë për shkëmbimin e informacionit ndërinstucional. Ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, institucion në varësi të MTM, është përgjegjëse për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave nëpërmjet sistemit GES. Skema e mëposhtme paraqet

<sup>5</sup> Strategjia e Ndryshimeve Klimatike, qershor 2019;

ndërveprimin e institucioneve të përfshira dhe shërben si një hartë konjitive e procesit në fokus të këtij auditimi:

Infografik nr. 1: Harta konjitive e institucioneve të përfshira



### 3.2 Baza ligjore që rregullon çështjen nën auditim

#### **Burimet e kritereve të politikës**

- Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);
- Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe planet e saj të veprimit, Qershor 2019;
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI).

#### **Burimet e kritereve të monitorimit dhe raportimit**

- Komunikimet kombëtare të Republikës së Shqipërisë për Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC);
- Raporti i Parë Dyvjeçar i Përditësuar për Shqipërinë;
- Raportime të tjera të MTM apo Ministrive të linjës.

#### **Burimet e kritereve teknike**

- Ligji nr. 75/2016, “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit, në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara, për Ndryshimet Klimatike”;
- Ligji nr. 155/2020, “Për ndryshimet klimatike”;
- Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10440, datë 07.07.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;
- Vendimi nr. 865, datë 10.12.2014, i Këshillit të Ministrave “Për reduktimin dhe stabilizimin e shkarkimeve të gazeve serrë të fluorinuara”;
- Vendimi nr. 762, datë 16.9.2015, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dokumentit për përcaktimin e kontributit kombëtar të pikësnyuar kundrejt arritjes së objektivit të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”;
- Urdhri nr. 155, datë 25.4.2014, i Kryeministrit “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërmintor të punës në fushën e ndryshimeve klimatike”;
- Rregullore e Brendshme e MTM.

#### **Burimet e kritereve të tjera/ Praktikrat më të mira**

- Direktiva 2003/87/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 13 tetor 2003 përcakton një skemë për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë brenda Komunitetit, që ndryshon Direktivën e Këshillit 96/61/EC;



- Direktiva 2004/101/ EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 27 tetor 2004, që ndryshon Direktivën 2003/87/EC e cila përcakton një skemë për kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë brenda Komunitetit;
- Direktiva 2009/29/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, e datës 23 prill 2009 që ndryshon Direktivën 2003/87/EC për të përmirësuar dhe zgjeruar kuotën tregtare të shkarkimit të gazeve serrë të Komunitetit.

### 3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Karakteri i NAP dhe orientimi i tij si një proces afatgjatë kërkon monitorim, raportim dhe rishikim të orientuar kah rezultateve. Qëllimet kryesore të këtij procesi vijues përfshijnë drejtimin efektiv të procesit, përfshirjen e njohurive dhe mësimëve të nxjerra, si dhe informacion transparent për palët e interesuara. Monitorimi dhe vlerësimi i përshtatjes synon:

- Drejtimin efektiv: Një proces i vazhdueshëm monitorimi dhe vlerësimi mundëson realizimin e qëllimeve gjithëpërfshirëse, pavarësisht pasigurive dhe risqeve nga zhvillimet e së ardhmes.
- Të mësuarit: Bazuar në tregues të saktë, është e mundur të identifikohen devijimet nga ajo që ishte projektuar më parë dhe përshtatja e procesit në intervale me zhvillimet reale.
- Llogaridhënien: Treguesit e përcaktuar qartë na jep mundësinë të kuptojmë nëse masat e miratuara të çuan në rezultatet e pritura.

Në funksion të realizimit të objektivave dhe misionit të saj institucional, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Grupit Ndërmnistror të Punës në fushën e ndryshimeve klimatike monitoron dhe vlerëson çdo 4 vjet progresin për zbatimin e dokumentit strategjik për ndryshimet klimatike dhe harton raportin, i cili përmban informacionin për zbatimin e Planit Kombëtar për Përshtatje ndaj Ndryshimeve Klimatike. Ky proces përfshin gjetjet e reja dhe vulnerabilitetin mbi ndryshimet klimatike, aktivitetet e kryera gjatë procesit të NAP-it, progresin dhe vështirësitë në integrimin e përshtatjes në sektorët e tjerë, progresin dhe vështirësitë në arritjen e objektivave e të indikatorëve, si dhe rekomandimet për masat në të ardhmen.

Bazuar në raportet dhe rezultatet e monitorimit, duhet të ketë një rishikim të rregullt të NAP-it çdo 8 vjet. Rishikimi do të përcaktojë nëse qëllimet, treguesit e procesit dhe qasjet e përgjithshme për arritjen e objektivave janë ende në përputhje me zhvillimet e reja në vend. Në rastet kur nevojiten ndryshime, procesi i rishikimit do të rekomandojë ndryshime konkrete të NAP-it.

Në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC), shteti shqiptar ka detyrë të raportojë në mënyrë periodike mbi progresin e arritur. Format kryesore të raportimit të Republikës së Shqipërisë në Konventë janë:

- a) komunikimet kombëtare;
- b) raportet e përditësimit dyvjeçar (BUR);
- c) raporti i zbatimit të NDC-së;
- d) raporti i inventarit kombëtar të shkarkimeve të GES-it.

Veprimtaria e MTM në këtë fushë nuk shtrihet vetëm në drejtim të raportimeve, por edhe të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit. Ministria bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për arsimin për hartimin dhe zbatimin e programeve në fushën e mjedisit e të ndryshimeve klimatike për të gjitha nivelet e arsimit. Për më tepër, Ministrinë e Linjës, brenda fushave të kompetencave shtetërore përkatëse ndërmarrin fushata informimi për të sensibilizuar e ndërgjegjësuar popullatën për efektet negative të ndryshimeve klimatike, për masat konkrete që mund të marrin për reduktimin e shkarkimeve të GES-it dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. MTM harton udhëzuesin për integrimin e çështjeve gjinore në programet e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike.

### 3.4 Peshë në buxhet

Në PBA-në e MTM-së nuk ka një program të dedikuar për sektorin e Ndryshimeve Klimatike. Për shkak të vlerës së buxhetit të MTM, ky sektor është përfshirë në programin e Mjedisit, ku Drejtoria për Ndryshimet Klimatike parashikon vetëm përgatitjen e akteve ligjore.

Financimi i Strategjisë për Ndryshimet Klimatike dhe Kontributit Kombëtar të Përcaktuar NDC 2021-2030, realizohet nëpërmjet tre burimeve kryesore: *(i)* buxhetit të shtetit, *(ii)* kontributit të donatorëve, si dhe *(iii)* sektorit privat.

Institucionet përgjegjëse për masat e parashikuara planifikojnë nevojat për financim buxhetor përmes programeve dhe linjave përkatëse buxhetore, si pjesë e procesit të planifikimit të programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor, në mënyrë që të sigurohet vënia në dispozicion e burimeve të mjaftueshme financiare për zbatimin e masave.

Duke qenë se ndryshimet klimatike janë një sektor gjithëpërfshirës, institucionet e identifikuar si përgjegjëse raportojnë në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit dhe burimin financiar. Njëkohësisht, edhe MTM në bashkëpunim me MFE-në monitorojnë dhe verifikojnë raportimet e kryera nga institucionet përgjegjëse për zbatimin e masave.

Lidhur me përcaktimin e kostove të përafërta dhe donatorëve të mundshëm për implementimin e masave, financimi i nevojshëm për zbatimin e masave të NDC-së për vitet 2021 -2030 është vlerësuar të jetë **153.5 miliardë Lekë ose 1,496 miliardë Euro**, sipas tabelës më poshtë “*Vlerësimi i detajuar i kostove për zbatimin e NDC-së për periudhën 2021-2030*”, e cila jep një përmbledhje të kostove dhe burimeve financiare.

Tabela nr.3: Kostot totale të vlerësuara për zbatimin e NDC-së për periudhën 2021-2030

Nr.	Masat	Kostot totale (000/lekë)
<b>1</b>	<b>Masat e Përshtatjes</b>	
1.1	Politikat dhe Qeverisja	498,070.2
1.2	Kapacitete shkencore, teknike dhe sociale	2,511,509.9
1.3	Përmirësimi i infrastrukturës rezidenciale, akomodimi dhe asetet turistike	984,000.0
1.4	Përshtatja mjedisore	161,068.5
1.5	Përshtatja nëpërmjet qasjeve të integruara me bazë ekosistemin (EbA) dhe/ose zgjidhje të bazuara tek natyra (NbS)	1,522,963.2
1.6	Promovimi i sektorit të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit miqësorë me klimën	-
1.7	Përmirësimi i menaxhimit të riskut në lidhje me fatkeqësitë natyrore	-
1.8	Promovimi i barazisë gjinore në terma të përshtatjes me ndryshimet klimatike	45,509.4
	<b>Kostot e Masave të Përshtatjes</b>	<b>5,723,121.1</b>
<b>2</b>	<b>Masat Zbutëse</b>	
2.1	Energjia	108,769,726.14
2.2	Proceset industriale	32,717.00
2.3	Menaxhimi i mbetjeve	387,053.40
2.4	Bujqësia	152,858.50
2.5	Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve	21,080,195.99
	<b>Kostot e Masave Zbutëse</b>	<b>130,422,551.03</b>
	<b>Totali</b>	<b>136,145,672.12</b>

*Burimi: MTM/ Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Siç vihet re edhe nga tabela e mësipërme, masat zbutëse përbëjnë 96% të kostove totale të vlerësuara të zbatimit të NDC-së. Pjesa më e madhe e kostos gjenerohet nga sektori i energjisë, i cili në total përbën 76.2% të masave zbutëse, ose 73% të dokumentit të NDC-së.

### 3.5 Përkufizimet dhe terminologjia

Në kuptim të këtij auditimi, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

**“Ndryshim klimatik”** është një ndryshim i klimës, që i atribuohet direkt apo indirekt aktivitetit të njeriut, i cili ndryshon përbërjen e atmosferës globale dhe që i shtohet ndryshueshmërisë natyrore të klimës, që vërehet në periudha kohe të krahasueshme.

**“Efekte të dëmshme të ndryshimeve klimatike”** janë ndryshimet në mjedisin fizik që rezultojnë nga ndryshimet klimatike, të cilat kanë efekte të rëndësishme negative mbi përbërjen, aftësinë vetë përtëritëse, produktivitetin e ekosistemeve natyrore apo të menaxhuara, funksionimin e sistemeve social-ekonomike apo mbi shëndetin dhe mirëqenien e njeriut e të kafshëve blegtorale.

**“Konventa”** është Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, miratuar në Nju Jork më 9 maj 1992, që ka hyrë në fuqi në Republikën e Shqipërisë më 1 janar 1995 dhe ku Republika e Shqipërisë është palë.

**“Përshtatje”** janë rregullimet e bëra nga njeriu në sistemet ekologjike, sociale, ekonomike ose proceset politike, në përgjigje të ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre.

**“Zbutje”** janë të gjitha përpjekjet e bëra për të reduktuar apo parandaluar shkarkimet e gazeve me efekt serrë, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme, që i bëjnë pajisjet e vjetra më eficiente ndaj konsumit të energjisë, që ndryshojnë praktikatat e menaxhimit apo sjelljen e konsumatorit.

**“Komunikimet Kombëtare”** janë dokumente periodike në formë raportimi që harton Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara.

**“Emergjencë klimatike”** është një situatë në të cilën kërkohet veprim urgjent për të zvogëluar ose ndaluar ndryshimet klimatike dhe për të shmangur dëmet e mundshme të pakthyeshme mjedisore që rezultojnë prej saj.


**“Kontributi Kombëtar”** është dokumenti i nivelit të synuar, në linjë me përpjekjet globale për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë (GES).

### **3.6 Skema e analizës së programit auditues**

Ky auditim u fokusua në implementimin e politikave të hartuara dhe efektivitetin e tyre, rolin dhe përgjegjësitë që subjektet e fushës kanë pasur në realizimin e tyre, duke u ndalur veçanërisht në:

- Hartimin dhe plotësinë e kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi;
- Ngritjen e strukturave të përshtatshme dhe roli i tyre në realizimin e objektivave të fushës;
- Fondet buxhetore që alokohen për të mbështetur këto struktura;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi midis palëve të përfshira në proces;
- Eficiencën e strukturave përgjegjëse në ndërgjegjësimin e publikut dhe palëve të treta.

Infografik nr. 2: Skema e analizës së programit të auditimit



Burimi: Grupi i auditimit

### 3.7 Feedback-u i subjektit përgjatë auditimit

Gjatë fazës studimore, grupi i auditimit bashkëpunoi me subjektin nën auditim, me qëllim vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i është përgjigjur kryesisht në kohë takimeve konsultuese, intervistave paraprake dhe kërkesave për informacion, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligji 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, me qëllim adresimin e problematikave reale të performancës së subjektit dhe përmirësimin e tyre pas rekomandimeve që do të japë KLSH.

Të njëjtën frymë bashkëpunimi grupi i auditimit e konstatoi edhe në fazën e terrenit. Gjatë kësaj faze, grupi i auditimit dërgoi pranë MTM-së intervistat për konfirmimin e të dhënave zyrtare, në përputhje me nenin 15, pika (dh) dhe (e) si dhe me nenin 26 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Intervista iu dërgua subjektit nën auditim në mënyrë elektronike. Përgjigjet e gjeneruara prej tij u përcollën në kohë dhe u trajtuan nga grupi i auditimit, me qëllim gjenerimin e gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve në përfundim të punës audituese.

## 4. DETAJET E AUDITIMIT

### 4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjektit

Risqet e politikave dhe aktiviteteve të subjektit të përfshirë në këtë auditim, kanë të bëjnë me vështirësitë dhe pengesat që ai has në realizimin e detyrave dhe funksioneve të përcaktuara në kuadrin ligjor e rregullator në fuqi. Për të kryer analizën e riskut, grupi i auditimit u mbështet në analizën SWOT.

Analiza SWOT paraqet fuqitë dhe dobësitë e institucionit që janë faktorë “brenda kontrollit menaxherial”, si dhe shanset dhe kërcënimet që janë faktorë “jashtë kontrollit menaxherial” ose të klasifikuara si risqe nga faktorë të brendshëm dhe risqe nga faktorë të jashtëm.


Kur risqet vijnë nga faktorë të brendshëm, institucioni duhet të mbështetet në fuqitë dhe të minimizojë dobësitë, ndërsa kur risqet vijnë nga faktorë të jashtëm institucioni duhet të shfrytëzojë shanset dhe të shmangë kërcënimet. Disa nga dobësitë institucionale që cenojnë menaxhimin me efektivitet të përcaktimit të veprimeve prioritare mbi klimën dhe implementimin e NAP, janë:

- Buxheti i PBA-ve më i ulët se nevojat e parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Ndryshimet Klimatike;
- Mungesë e një sistemi të dhënash të detajuara në nivel qendror;
- Numër i ulët i stafit teknik të angazhuar në çështjet e ndryshimeve klimatike;
- Mungesa e sistemit të monitorimit.

Infografik nr. 3: Analiza SWOT

- FAKTORË TË BRENDSHËM**
- Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”
  - Strategjia për Ndryshimet klimatike (Plani Kombëtar për Adaptimin ndaj Ndryshimeve Klimatike)
  - Krijimi i një grupi ndërinstytucional “Ad-hoc”, me qëllim monitorimin e veprimeve të ndërmara në kuadër të NAP;
  - Strukturë e dedikuar mbi ndjekjen, monitorimin, vlerësimin dhe raportimin e masave dhe veprimeve mbi ndryshimet klimatike;
  - Raporte periodike të Qeverisë Shqiptare (Komunikimet 4 vjeçare Kombëtare lidhur me klimën).

- FAKTORË TË JASHTËM**
- Ndihma e huaj me projekte dhe financime lidhur me procesin e adaptimit;
  - Progres Raporte të BE-së mbi vlerësimin e Shqipërisë për klimën;
  - NGO të angazhuara në projekte/studime mbi efektet dhe pasojat e ndryshimeve klimatike.



- Buxheti i PBA-ve më i ulët se nevojat e parashikuara në Planin Kombëtar për Adaptimin ndaj Ndryshimeve Klimatike;
- Mungesë e një sistemi të dhënash të detajuara në nivel qendror sa i përket masave të ndërmara në kuadër të NAP;
- Numër i ulët i stafit Teknik të angazhuar në çështjet e ndryshimeve klimatike;
- Mungesa e sistemit të monitorimit të NAP.

- Përafrimi me acquis komunitare i kufizuar;
- Shqipëria, vendi më i rrezikuar ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike në pellgun e Mesdheut (sipas IPCC);
- Fragmentimi i kompetencave dhe risku i mungesës së koordinimit ndër institucional për zbatimin e NAP;
- Mungesë e objektivave mbi zhvillimin e kapaciteteve të stafit teknik përgjegjës për ndryshimet klimatike.

Burimi: Grupi i Auditimi

Pasi u paraqitën risqet e mjedisit të jashtëm dhe risqet e mjedisit të brendshëm që cenojnë menaxhimin me efektivitet të përcaktimit të veprimeve prioritare mbi klimën dhe implementimin e NAP, më poshtë është paraqitur klasifikimi i tyre në risk strategjik, teknik dhe operacional.

Tabela nr. 4: Klasifikimi i risqeve strategjike, teknike dhe operacionale

	Ulët	Mesatare	Lartë
Strategjike		Buxheti i Programeve Buxhetore Afatmesme më i ulët se nevojat e parashikuara në Planin Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike.	Mungesë e objektivave mbi zhvillimin e kapaciteteve të stafit teknik përgjegjës për ndryshimet klimatike.

<b>Teknike</b>		Numër i ulët i stafit teknik të angazhuar në çështjet e ndryshimeve klimatike. Përafrimi me acquis komunitare i kufizuar.	Mungesë e një sistemi të dhënash të detajuara në nivel qendror sa i përket masave të ndërmarra në kuadër të NAP.
<b>Operative</b>			Mungesa e sistemit të monitorimit. Fragmentimi i kompetencave dhe risku i mungesës së koordinimit ndër institucional për zbatimin e NAP.

*Burimi: Grupi i Auditimi*

#### **4.2 Objektivi i auditimit**


Auditimi me temë “Zbatimi i Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” kishte si objektiv kryesor vlerësimin e implementimit të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike (NAP). Në këtë mënyrë u synua të sigurohet një vlerësim i paanshëm dhe objektivi i eficiencës dhe efektivitetit të institucioneve të përfshira, në drejtim të implementimit të objektivave të përcaktuara nga NAP dhe rritjes së kapaciteteve institucionale.

Sa kaq, grupi i auditimit vlerësoi:

1. Efektivitetin e implementimit të sistemit të monitorimit dhe raportimit të NAP;
2. Efektivitetin menaxhimit të fondeve për veprimet prioritare të ndërmarra mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
3. Eficiencën e strukturave të ngritura me qëllim zbatimin e NAP.



### 4.3 Pyetjet e auditimit



Burimi: Grupi i auditimit

**Pyetja kryesore:** A ka siguruar MTM mirë administrimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike?

**Pyetjet e nivelit të parë:**

A ka garantuar MTM zbatimin e veprimeve prioritare të parashikuara në NAP?

A ka luajtur MTM një rol proaktiv në përfitimin e fondeve për ndryshimet klimatike?

**Pyetjet e nivelit të dytë:**

A janë ngritur strukturat e nevojshme dhe a është realizuar rritja e kapaciteteve me qëllim implementimin e NAP?

A është ngritur një sistem monitorim-vlerësimi, i cili ndjek statusin e zbatimit të veprimeve prioritare dhe mundëson bërjen e modifikimeve në procesin e NAP-it?

A është krijuar një strukturë e dedikuar për nxitjen dhe përthithjen e financimeve klimatike?

Si ka qenë ecuria e fondeve të përthithura për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike?

#### 4.4 Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim u fokusua në vlerësimin e masave të marra me qëllim zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes për Ndryshimet Klimatike. Periudha e auditimit përfshin vitet 2020-2023. Nxitja për ndërmarrjen e këtij auditimi performance erdhi si pasojë e faktit se KLSH nuk ka zhvilluar më parë një auditim në këtë fushë. Vizioni kombëtar fokusohet fort në tre komponent kryesorë të ndryshimit të klimës në Shqipëri: masat zbutëse, përshtatja dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Masat zbutëse përfshijnë të gjitha veprimtaritë e ndërmarra në kuadër të reduktimit dhe parandalimit të shkarkimeve të gazrave serrë, përfshirë përdorimin e teknologjive të reja dhe energjive të rinovueshme. Ndërkohë që, masat adaptuese përfshijnë masat e ndërmarra me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve aktuale apo të pritshme të klimës, efekteve apo ndikimeve të tyre. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit, Shqipëria ka nisur një proces të ri të politikave klimatike bazuar në kërkesat ndërkombëtare. Kufizimi i efekteve të ndryshimeve klimatike është thelbësor, për të garantuar përshtatjen me kosto të arsyeshme ekonomike, mjedisore dhe sociale. Ky proces merr një rëndësi të veçantë në vende me cënueshmëri të lartë si Shqipëria.<sup>6</sup> Nisur nga temat e propozuara nga INTOSAI WGEA dhe IDI në kuadër të projektit ndërkombëtar mbi të cilin po zhvillohet ky auditim, grupi auditimit u fokusua në vlerësimin e zbatimit të Planit Kombëtar për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe masave të parashikuara në të.

Tabela nr. 5: Skema e Fushëveprimit e Projektit Auditues

<i>Cfarë?</i>	Vlerësimi i masave të marra me qëllim zbatimin dhe monitorimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes për Ndryshimet Klimatike.
<i>Kë?</i>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit/Agjencia Kombëtare e Mjedisit/Grupi Ndërministror Sektorial.
<i>Ku?</i>	Intervista; Pyetësorë; Shqyrtim dokumentacioni dhe Analizë të dhënash.
<i>Kur?</i>	2020-2023

*Burimi: IDI Handbook/ Përpunoi: Grupi i Auditimit*

<sup>6</sup> <https://www.co-plan.org/forumi-kombetar-per-ndryshimet-klimatike/>;

## 5. SHTJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

### **Pyetja kryesore: A ka siguruar MTM mirë administrimin e planit kombëtar për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike?**

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, fokusimit të problemit, përcaktimit të objektivave në fazën studimore, analizimit dhe testimit të evidencave gjatë fazës analitike, grupi arriti në këtë mesazh auditimi:


Gjatë dy dekadave të fundit, sfida e ndryshimeve klimatike është përballur me një qasje për përgjegjësi të përbashkët në nivel ndërkombëtar. Kjo përfshin përpjekje për shtimin e masave të përshtatjes për të luftuar ndikimet e dëmshme të ndryshimeve klimatike që janë ndërkaq të pashmangshme. Nëpërmjet hartimit të Planit Kombëtar të Përshtatjes, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit synon marrjen e masave të suksesshme, me qëllim kundërpërgjigjen ndaj ndryshimeve klimatike. Megjithatë, pavarësisht veprimeve prioritare të përcaktuara, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka luajtur një rol proaktiv në respektim të nismës integruese gjithëpërfshirëse për procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete të përshtatshme në vend. Nuk është krijuar një sistem i mirëfilltë monitorimi dhe vlerësimi dhe pjesa më e madhe e financimit të klimës në Shqipëri është shumë e varur nga komuniteti ndërkombëtar dhe donatorët. Në vijim, është e rëndësishme që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa, me qëllim që procesi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike të jetë më efektiv, duke siguruar zbatimin e masave dhe nxjerrjen e mësimave në mënyrë periodike.

### **5.1 A ka garantuar MTM zbatimin e veprimeve prioritare të parashikuara në NAP?**

#### **5.1.1 A janë ngritur strukturat e nevojshme dhe a është realizuar rritja e kapaciteteve me qëllim implementimin e NAP?**

Ngritja e kapaciteteve është thelbësore për arritjen e qëllimeve të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike (UNFCCC) dhe Marrëveshjes së Parisit (neni 11) dhe është identifikuar si një prioritet në kontributet kombëtare të përcaktuara (NDC) të vendeve. Shumë vende në zhvillim, veçanërisht vendet më pak të zhvilluara, kanë ende boshllëqe dhe nevoja në këtë fushë dhe kërkojnë mbështetje për ngritjen e kapaciteteve në nivel individual, institucional dhe sistematik. Më poshtë është paraqitur në mënyrë skematike procesi i rritjes së kapaciteteve, siç përshkruhet në UNFCCC.

Infografik nr. 5: Procesi i rritjes së kapaciteteve sipas UNFCCC



*Burimi: UNFCCC/ Përpunoi: Grupi i Auditimit*

Në kuadër të procesit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, subjektet të cilat përfshihen në proceset e rritjes dhe zhvillimit të kapaciteteve mund të jenë të ndryshme dhe të larmishme. Edhe pse perceptimi i përgjithshëm është që përfituesi kryesor i tyre është sektori publik, është me rëndësi që këto procese të përfshijnë edhe sektorin privat, shoqërinë civile, etj.

Rritja e kapaciteteve për sa i përket ndryshimeve klimatike është adresuar gjerësisht ndër vite dhe është përfshirë në disa nene të UNFCCC. Në mënyrë të veçantë për trajnimin e stafit dhe ndërgjegjësimin e publikut, neni 6 i Konventës u kërkon shteteve të fuqizojnë dhe angazhojnë të gjithë aktorët dhe grupet kryesore në politikën që lidhen me ndryshimet klimatike, një thirrje që e përforcon edhe neni 10/e i Protokollit të Kiotos.

Në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike, vendet palë bëjnë raportime periodike (Komunikime Kombëtare), të cilat duhet të përfshijnë gjashtë komponentë kyçë, ku ndër të tjera edhe për “*kufizimet dhe mangësitë, si dhe nevojat financiare, teknike dhe të ndërtimit të kapaciteteve*”.

Në vitin 2015, rritja dhe zhvillimi i kapaciteteve u adresua edhe në Marrëveshjen e Parisit. Neni 11 i Marrëveshjes së Parisit përcakton qëllimet e ndërlidhura me ndërtimin e kapaciteteve, parimet udhëzuese dhe detyrimet procedurale për të gjitha palët. Ai u bën thirrje vendeve të zhvilluara të rrisin mbështetjen për rritjen e kapaciteteve në vendet në zhvillim, dhe këtyre të fundit që të komunikojnë rregullisht progresin në zbatimin e planeve, politikave, veprimeve ose masave për ndërtimin e kapaciteteve. Marrëveshja kërkon gjithashtu ndërtimin e kapaciteteve të bazuar në nevojat e vendeve përfituese. Marrëveshja e Parisit njeh edhe rëndësinë e trajnimit për ndryshimet klimatike, ndërgjegjësimin publik, pjesëmarrjes dhe aksesit të publikut në informacion dhe u kërkon palëve të bashkëpunojnë për marrjen e masave të duhura. Ndërkohë, Konferenca e Palëve krijoi Komitetin e Parisit për Ngritjen e Kapaciteteve (PCCB) si një organ të ri, i cili synon të adresojë nevojat dhe boshllëqet, si aktuale ashtu edhe të parashikuara, dhe të rrisë më tej përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve.

### *Projektet e zbatuara në fushën e ndryshimeve klimatike që lidhen me rritjen e kapaciteteve*

Në Komunikimin e Katërt Kombëtar që Shqipëria ka bërë në kuadër të Konventës përcaktohen një sërë projektesh në fushën e ndryshimeve klimatike, të cilat janë zbatuar në vendin tonë që nga viti 2016. Disa prej këtyre projekteve që lidhen edhe me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë ende në proces, përkatësisht:

#### **TRATOLOW**

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe zhvillimin drejt një ekonomie me efikasitet të burimeve, emetime të ulëta dhe rezistente ndaj klimës. Me ndihmën e një konsorciumi evropian, Komisioni Evropian po mbështet vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë në fushat e mbrojtjes së klimës dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky projekt synon të vijë në ndihmë vendeve të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnje Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Serbia) dhe Turqisë. Projekti është i ndarë në katër grupe pune dhe përfshin pesë komponentë si më poshtë:

Grupi i Punës 1 – Politika Horizontale Klimatike;

Grupi i Punës 2 – Gazet me Efekt Serrë (GES);

Grupi i Punës 3 – Sistemi i Tregtimit të Emetimeve të BE-së (ETS);

Grupi i Punës 4 – Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike.

Komponenti 1 – Mbështetje dhe rritje kapacitetesh për zbatimin e angazhimeve sipas Marrëveshjes së Parisit dhe strategjisë afatgjatë të BE-së për Klimën dhe Energjinë 2030 & 2050

Komponenti 2 – Rritja e kapaciteteve për inventarët e gazeve me efekt serrë (GHG), dhe përmirësimi i kuadrit ligjor.

Komponenti 3 – Rritje kapacitetesh për monitorimin, raportimin, akreditimin dhe verifikimin për operatorët, autoritetet, verifikuesit dhe OSHC-të.

Komponenti 4 – Mbështetje për Planifikimin dhe Masat që duhen marrë për tu përshtatur ndaj efekteve negative të ndryshimeve klimatike në nivel kombëtar dhe rajonal.

Komponenti 5 – Kontrolli i përputhshmërisë së Akteve Ligjore.

#### **SANE27 II**

Është një projekt i financuar nga SIDA dhe që mbështet ministrinë në procesin e integritit sidomos për Kapitullin 27 (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike). Projekti ka mbështetur ministrinë në fazën e shqyrtimit analitik (Screening) dhe po ashtu do të vazhdojë mbështetjen për procesin e negociatave për këtë kapitull (përgatitja e Negotiating Position) plotësimi i Piketave Hyrëse (Opening Benchmarks) etj. Projekti pritet të vazhdojë deri në shkurt 2026.

### **AVANCIMI I PLANIFIKIMIT TË SHQIPËRISË PËR PËRSHTATJEN AFATMESME DHE AFATGJATË NËPËRMJET ZHVILLIMIT TË NJË PROCESI TË PLANIFIKIMIT KOMBËTAR TË PËRSHTATJES**

Financuar nga Fondi i Gjellbër i Klimës, si pjesë e Programit të Mbështetjes së Gatishmërisë dhe zbatuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe UNDP. Zbatimi i këtij projekti synon t'i mundësojnë Shqipërisë ndërtimin dhe forcimin e kapaciteteve për integrimin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, prodhimin e vlerësimeve të zbatueshme të rreziqeve klimatike dhe cënueshmërisë, dhe zbatimin e metodave, mjeteve dhe sistemeve të informacionit efektive për të informuar më mirë vendimmarrjen mbi rreziqet klimatike dhe për të drejtuar investimet klimatike. Ai gjithashtu do të mbështesë formulimin e strategjive dhe mekanizmave të financimit për shkallëzimin e përshtatjes në periudhën afatmesme dhe afatgjatë. Projekti kombinon punën në nivel qendror dhe lokal. Në nivel qendror sektorët e fokusit janë turizmi, zhvillimi urban, bujqësia, transporti dhe energjia. Në nivel lokal, synohet të asistohen tetë bashki (Durrës, Krujë, Vlorë, Elbasan, Kukës, Fier, Gjirokastrë, Përmet) në hartimin e planeve lokale për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Projekti do t'i mundësojë Shqipërisë të planifikojë dhe të tërheqë financa në shkallë më të gjerë për të ardhmen, duke forcuar proceset e planifikimit të përshtatjes nëpërmjet:

- Forcimit të mandatit kombëtar, strategjisë dhe mekanizmit drejtues që fokusohet në vlerësimin dhe adresimin e boshllëqeve të kapaciteteve (veçanërisht në sektorët prioritarë të turizmit, zhvillimit urban, bujqësisë, transportit dhe energjisë);
- Hartimit të një dokumenti të planit të veprimit të Strategjisë së NAP-it dhe planin i zbatimit të tij;
- Zhvillimit të strategjive të financimit, monitorimit dhe vlerësimit për të siguruar që kapacitetet dhe opsionet e financimit të institucionalizohen për qëndrueshmërinë afatgjatë.

Në linjë me instrumentet ndërkombëtarë, kapacitetet adekuate administrative, ndërgjegjësimi i publikut, shkëmbimi i informacionit, komunikimi dhe angazhimi janë elemente të rëndësishme për rritjen në mënyrë të efektshme të aftësisë ripërtëritëse ndaj ndryshimeve klimatike edhe në Shqipëri. Struktura përgjegjëse për ndryshimet klimatike në MTM që nga janari 2023 është Drejtoria për Ndryshimet Klimatike, e cila ka 5 persona në strukturën e saj (4 specialistë dhe drejtori). Nga viti 2017 deri në 2022 drejtoria përgjegjëse për ndryshimet klimatike quhej Drejtoria për Zhvillimin e Politikave dhe Strategjive për Zhvillimin e Mjedisit.

Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike, si një qasje relativisht e re, ende nuk mbështetet me kapacitete adekuate në vend. Ekziston një nevojë e ngutshme për të zhvilluar dhe mbështetur më tej kapacitetet institucionale dhe për të vendosur bazën për të vepruar, duke u dalë përpara ndryshimeve klimatike në të gjitha politikat sektoriale përkatëse. Kjo vlen në nivel qendror, rajonal, të komuniteteve dhe OJQ-ve<sup>7</sup>. Vlerësimi i situatës aktuale ka identifikuar nevojat të konsiderueshme për ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale<sup>8</sup>. Planifikimi dhe zbatimi i përshtatjes nënkupton nevojën për kapacitete institucionale dhe aftësi individuale në institucione të ndryshme dhe në disa nivele administrative (që nga politikat e deri në nivel operativ).

Kjo nevojë është reflektuar në veprimin prioritar nr. 6 të Strategjisë për Ndryshimet Klimatike “Nisma për ngritjen e kapaciteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”. Kjo e fundit përcakton elementet kryesorë dhe afatet e këtij veprimi prioritar si më poshtë:

- Masa 1: Ministria e Turizmit dhe Mjedisit do të hartojë një plan koherent trajnimi me mbështetjen e donatorëve që janë aktivë në këtë fushë. Plani i trajnimit do të përcaktojë se cilat boshllëqe në njohuri do të trajtohen për cilin veprim të procesit të NAP-it. Plani do të përcaktojë edhe burimet dhe mbështetjen për kontributet e trajnimit (2018).
- Masa 2: Do të zhvillohen trajnime të synuara për tema të përzgjedhura sipas planit të trajnimit. Trajnimet do të ndjekin konceptet didaktike interaktive konceptuale dhe do të sigurojnë që të kenë shumë lidhje me punën praktike të pjesëmarrësve (2018).
- Masa 3: Do të mbështeten disa masa të përzgjedhura dhe në bazë të kërkesës për zhvillimin e kapaciteteve institucionale gjatë procesit të NAP-it (2018 - 2019).

### **Planifikimi i trajnimeve bëhet rast pas rasti, në varësi të projekteve që zbatohen nga donatorët dhe nuk është proces i vazhduar dhe integral në MTM**

Midis 2019 dhe 2023, Shqipëria kishte një shkallë të ulët realizimi në përgjithësi, me vetëm 15% të masave përshtatëse të raportuara si të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit. Nga pikëpamja pozitive, janë marrë masa për të filluar zbatimin për rreth 69% të të gjitha masave të përfshira në NAP gjatë periudhës 4-vjeçare të zbatimit. Kjo përqindje përfaqëson totalin kumulativ të masave që janë iniciuar, janë në vazhdim, pjesërisht të përfunduara ose të përfunduara plotësisht. Vlen të theksohet se zbatimi aktiv i masave ka ndodhur kryesisht nga fundi i vitit 2021 e në vazhdim. MTM sqaron se, si çdo fushë tjetër, edhe zbatimi i veprimeve prioritare është ndikuar nga tërmeti i vitit 2019 në Shqipëri, i cili bëri një rialokim të financimit drejt përpjekjeve për rindërtim dhe ndërprerjet e konsiderueshme të shkaktuara nga pandemia COVID-19 në 2020 dhe 2021.

Aktivitetet e parashikuara në Veprimin Prioritar nr. 6 duhet të mbylleshin brenda vitit 2018 dhe nuk u përditësuan as me miratimin e strategjisë për ndryshimet klimatike, edhe pse kjo e fundit u miratua në 2019. Nisur nga natyra e këtyre veprimeve, mund të themi se ato duhet të kryhen vazhdimisht në

<sup>7</sup> Plani Kombëtar i Përshtatjes (NAP) i Shqipërisë;

<sup>8</sup> Strategjia për Ndryshimet Klimatike;



kuadër të procesit të ngritjes së kapaciteteve dhe nuk kufizohen vetëm në vitet e përcaktuara. Planet e kërkuara të trajnimeve janë hartuar vetëm rast pas rasti në kuadër të projekteve specifike që zbatohen në fushën e ndryshimeve klimatike.

Duke marrë në konsideratë nevojën që kuadri strategjik i fushës të jetë i përditësuar dhe në linjë me zhvillimet e viteve të fundit, MTM sqaron se aktualisht po rishikohet Plani Kombëtar i Përshtatjes, i cili është parashikuar të miratohet brenda vitit 2025 dhe se brenda 2024, në takimet që do të organizohen me përfaqësuesit e grupit të punës do të rishikohen masat dhe afatet e këtyre veprimeve. Aktualisht, financimi i trajnimeve, planifikimi i tyre dhe procesi i vlerësimit të nevojave kryhet vetëm në kuadër të projekteve të zhvilluara në bashkëpunim me donatorë të jashtëm. Planifikimi i trajnimeve në këtë drejtim bëhet rast pas rasti, në varësi të projekteve që zbatohen nga donatorët dhe nuk është proces i vazhduar dhe integral në MTM. Konkretisht, vlerësimi i nevojës për trajnime të stafit është kryer rishtazi nga projekti i UNDP. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2024, MTM do të zbatojë këtë program trajnimi njëvjeçar mbi procesin e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, i cili përfshin modulet si më poshtë:

1. Përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike/ BE, perspektiva ndërkombëtare dhe kombëtare;
2. Integrimi i çështjeve gjinore në politikat e ndryshimeve klimatike;
3. Vlerësimi i rrezikut dhe cënueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike/Identifikimi dhe prioritizimi i masave përshtatëse;
4. Integrimi i përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike në politikat sektoriale;
5. Mekanizmat financiarë për adresimin e ndryshimeve klimatike/Gjurmueshmëria e financimit të klimës;
6. Monitorimi dhe Vlerësimi i ndryshimeve klimatike;
7. Teknologjitë për adresimin e ndryshimeve klimatike.

Në kuadër të këtij projekti, deri më tani janë zhvilluar dy modulet e para me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse, si dhe dy takime konsultuese me qëllim trajnimin e Bashkive për hartimin e planeve lokale për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

### **Procesi i koordinimit ndërinstitucional mes MTM-së dhe institucioneve të linjës apo të varësisë sa i përket angazhimit në trajnime ka qenë i cunguar**

Nga intervistat e kryera, rezulton se problematik është angazhimi i pakët dhe sistematik apo mungesa e stafeve të dedikuara për ndryshimet klimatike në institucionet e linjës apo të varësisë. Këta të fundit nuk përcaktojnë persona apo struktura përgjegjëse, të cilat mund të shërbejnë si pika kontakti dhe koordinimi me MTM, në lidhje me forcimin e kapaciteteve për ndryshimet klimatike. Nëpunësit civilë që punojnë në MTM, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore kanë një informacion të përgjithshëm dhe sipërfaqësor mbi NAP. Ndërkohë që, vetëm një përqindje e vogël e punonjësve kanë njohuri adekuate për përmbajtjen e Veprimeve Prioritare specifike, qëllimet dhe treguesit që lidhen me institucionin dhe/ose sektorin e tyre.

Shqipëria ka ndërmarrë veprime për përshtatjen klimatike, të mbështetura kryesisht nga donatorët ndërkombëtarë. Këto veprime, të zbatuara në baza ad-hoc, nuk kanë pasur një koordinim dhe qasje shumë-sektoriale për të adresuar dobësitë klimatike kombëtare. Çdo projekt adreson një sërë çështjesh në vend që të fokusohet thellë në një ose disa. Kjo pasqyron fazën aktuale të Shqipërisë në përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, duke u fokusuar më shumë në politika, legjislacion, ndërgjegjësim dhe rritjen e kapaciteteve dhe më pak në integrimin ose adresimin e plotë të çështjeve specifike.

### **Mungesa e zhvillimit të analizave në lidhje me ndikimin dhe vlerësimin e projekteve të përfunduara në drejtim të forcimit të kapaciteteve**

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se mungojnë analizat e ndikimit dhe vlerësimit të projekteve të përfunduara në drejtim të forcimit të kapaciteteve, por edhe të nxjerrjes së mësimave për aktivitetet

që mund të përmirësohen në të ardhmen. Kjo nënkupton se, pavarësisht faktit se shteti jonë është në fazën e përditësimit të NAP dhe rishikimit të veprimeve prioritare, MTM nuk ka kryer asnjë analizë lidhur me nivelin zbatueshmërisë së objektivave të përcaktuara në VP. Nga viti 2019<sup>9</sup> e në vijim, MTM duhet të kishte gjeneruar çdo vit progres raport lidhur me zbatueshmërinë e veprimeve prioritare dhe objektivave të tyre. Raporti i Parë i Progresit të NAP 2023 është i vetmi dokument, që trajton ecurinë e zbatimit të këtyre veprimeve, por ky akt nuk është miratuar dhe nuk ka fuqi juridike. Në Ligjin nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, kreu V rregullon ngritjen e kapaciteteve, edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen e publikut. Konkretisht, neni 25 parashikon se Ministrinë e linjës bashkëpunojnë në mënyrë efektive, eficiente, të integruar e të programuar për ngritjen e kapaciteteve të tyre, të bashkive, të institucioneve financiare, të sektorit privat e të organizatave jofitimprurëse (OJF-ve) për zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, sipas fushës së tyre të përgjegjësive.

Gjatë periudhës 2022-2023 janë organizuar disa aktivitete për rritjen e kapaciteteve. Në takime janë përfshirë përfaqësues nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Natyrore, Ministria e Shëndetësisë, Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Instituti i Shëndetit Publik, etj. Gjithashtu, në kuadër të projektit të financuar nga UNDP për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, bashkitë janë trajnuar dhe po përgatisin plane lokale përkatësisht në Kukës, Elbasan, Vlorë, Durrës, Gjirokastrë, Fier, Krujë dhe Përmet. Në lidhje me angazhimin e palëve të tjera të interesit, disa OJF janë angazhuar për rritjen e njohurive të target grupeve të ndryshme, në lidhje me ndryshimet klimatike.

**Gjetje nga auditimi 1:** Planifikimi i trajnimeve në fushën e ndryshimeve klimatike është bërë vetëm rast pas rasti, në varësi të projekteve që zbatohen nga donatorët e huaj dhe nuk është proces i vazhduar dhe integral në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe institucionet e tjera përgjegjëse.

**Gjetje nga auditimi 2:** Nga auditimi është konstatuar se nuk zhvillohen analiza në lidhje me impaktin dhe vlerësimin e projekteve të përfunduara në drejtim të forcimit të kapaciteteve.

**Gjetje nga auditimi 3:** Procesi i koordinimit ndër-institucional mes Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe institucioneve të linjës apo të varësisë sa i përket angazhimit në trajnime ka qenë i cunguar. Kjo sepse, këto institucione nuk përcaktojnë persona apo struktura përgjegjëse, në përputhje dhe me përshtatjet e tyre të punës, të cilët mund të shërbejnë si pika kontakti dhe koordinimi me MTM në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme, në lidhje me forcimin e kapaciteteve për ndryshimet klimatike. Vetëm një përqindje e vogël e nëpunësve kanë njohuri adekuate për përmbajtjen e Veprimeve Prioritare specifike, qëllimet dhe treguesit që lidhen me institucionin dhe sektorin e tyre. Ndërkohë që, për projektin “*Tratolow*” nuk ka të dhëna për personat pjesëmarrës në trajnime nga MTM dhe ministrinë e linjës.

### **Konkluzione:**

1. Procesi i rritjes së kapaciteteve në kuadër të përshtatjes së ndryshimeve klimatike ka mangësi të theksuara. Të gjitha hallkat e tij nuk janë pjesë e një sistemi të vazhduar, por kryhen rast pas rasti në zbatim të projekteve të financuara nga donatorët të huaj, gjë e cila rrezikon të krijojë edhe mbivendosje në kurrikulat e trajnimeve të ndryshme. Për më tepër, mungojnë tërësisht analizat e impaktit dhe vlerësimit të projekteve të përfunduara, duke cenuar procesin e *follow-up* dhe nxjerrjen e mësimave për aktivitetet që mund të përmirësohen në të ardhmen. Gjithashtu, kuadri rregullativ është i papërditësuar dhe nuk përcakton objektivat që duhet të arrihen nëpërmjet procesit të rritjes së kapaciteteve. Ekziston një mungesë e përhapur e njohurive dhe aftësive institucionale në lidhje me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, jo vetëm në nivel kombëtar,

<sup>9</sup> Vit në të cilin është miratuar NAP;

por edhe në nivel lokal. Të gjitha këto probleme reflektohen edhe në angazhimin që tregojnë institucionet përgjegjëse të linjës apo të varësisë.

**Rekomandim 1.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të zhvillojë procesin e vlerësimit të nevojës për trajnim në mënyrë sistematike, edhe jashtë kuadrit të projekteve specifike, duke krijuar një panoramë të qartë të çështjeve që kanë më shumë nevojë për t'u trajtuar në vazhdimësi.

**Në vazhdimësi**

**Rekomandim 2.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë analiza të impaktit dhe vlerësimit të projekteve të përfunduara në drejtim të forcimit të kapaciteteve, duke mbajtur në konsideratë shkallën e arritjes së objektivave, rezultatet, si dhe mësimet e nxjerra për përmirësimin e aktiviteteve të ardhshme.

**Në vazhdimësi**

**Rekomandim 3.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të kërkojë pranë institucioneve të linjës përcaktimin e personave përgjegjës për kontaktin dhe koordinimin e aktiviteteve të lidhura me ndryshimet klimatike.

**Menjëherë**


### **5.1.2 A është ngritur një sistem monitorim-vlerësimi, i cili ndjek statusin e zbatimit të veprimeve prioritare dhe mundëson bërjen e modifikimeve në procesin e NAP-it?**

Monitorimi dhe Vlerësimi janë veprime, të cilat mundësojnë ndjekjen e përparimit drejt progresit të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike dhe dobishmërisë së zbatimit të veprimeve prioritare të parashikuara në NAP. Problemet e lidhura me ndryshimet klimatike janë komplekse dhe prekin një gamë të gjerë sektorësh, për pasojë rrjedhimisht kërkojnë bashkëpunim të shëndoshë ndërinstitucional për arritjen e objektivave si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Monitorimi dhe Vlerësimi i NAP janë dy procese të ndryshme, por që ndërlidhen me njëri tjetrin.

- **Monitorimi** është grumbullimi sistematik dhe i vazhdueshëm i informacionit që mundëson kontroll nëse një ndërhyrje është e dobishme dhe i përgjigjet risqeve apo objektivat e vendosura janë të duhurat. Monitorimi efektiv përfshin një sistem raportimi të koordinuar dhe mekanizma reagimi të përgjegjshëm.
- **Vlerësimi** është një proces sistematik i një ndërhyrjeje në një moment të caktuar kohor, për shembull nëse një politikë ka qenë efektive në arritjen e objektivave të përcaktuara.

E përbashkëta ndërmjet këtyre dy proceseve, konsiston në faktin se nëpërmjet të dyjave synohet të gjurmohet progresi në zbatimin e ndërhyrjeve të përshtatjes dhe/ose sesi këto ndërhyrje po reduktojnë çënueshmërinë, duke përmirësuar masat e ndërmarra dhe përshtatur kapacitetet në dispozicion, me qëllim garantimin e përmirësimit të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm. Këto aktivitete kanë një impakt pozitiv edhe në memorien institucionale, nëpërmjet punës së ekipeve të ekspertëve, të cilët duhet të monitorojnë, raportojnë dhe verifikojnë të dhënat dhe gjenerojnë në kohë dokumentet kombëtare, duke mundësuar kështu një proces transparent dhe informuar qytetarët dhe palët e interesit lidhur me kontributin e Shqipërisë në realizimin e objektivave afatgjatë të Marrëveshjes së Parisit.

Figura nr. 2: Procesi i Monitorimit dhe Vlerësimit të NAP



Burimi: GIZ – Udhëzues për zhvillimin e Sistemeve Kombëtare të Monitorimit & Vlerësimit

**Grupi ndërministror i punës nuk është mbledhur në mënyrë periodike sipas parashikimit të Urdhërit të Kryeministrit. GNPNK nuk ka zhvilluar mbledhje të rregullta dhe takimi i fundit i tij është mbajtur në datën 1 Mars 2023.**

Për të siguruar që NAP në vendin tonë është efektiv dhe i qëndrueshëm me kalimin e kohës, është e rëndësishme të monitorohet rregullisht progresi i tij. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e këtij procesi, veprimi prioritar nr.4 i NAP ka parashikuar “Ngritjen e një Sistemi Monitorimi për Zbatimin e NAP”. Qëllimi që synohet të realizohet nëpërmjet këtij veprimi prioritar është të gjurmohet ecuria e përgjithshme të procesit të NAP, duke u fokusuar në mënyrë eksplicite në procesin dhe monitorimin e zbatimit të të gjitha VP-e, duke matur arritjet në zbatimin e politikave, planeve, ndërhyrjeve dhe investimeve të lidhura me përshtatjen. Më konkretisht, VP nr. 4 synon të krahasoj rezultatet aktuale kundrejt objektivave fillestarë që janë përcaktuar gjatë zhvillimit të NAP, duke vlerësuar nëse kapacitetet e nevojshme janë të vendosura për zbatimin e planit dhe gjurmimi i progresit në integrimin e ndryshimeve klimatike në dokumentet strategjike sektoriale dhe planifikimin buxhetor.

Për sa i përket MRV-së për përshtatjen, pika kombëtare e kontaktit është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit. Raportimet kombëtare për përshtatjen me ndryshimet klimatike bëhen nga një grup pune ndërministror (Komiteti Kombëtar për Ndryshimet Klimatike). Ministrinë e linjës angazhojnë një ekspert të brendshëm, i cili shërben si pikë për shkëmbimin e informacionit ndërinstucional. Ndërkohë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, institucion në varësi të MTM, është përgjegjëse për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave.

Grupi i punës në fushën e Ndryshimeve Klimatike, krijuar në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014 dhe i kryesuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, do të vlerësojë çdo vit, përparimin e strategjive kombëtare dhe planeve që lidhen me ndryshimet klimatike. Çdo vit, ministrinë përkatëse duhet të raportojnë mbi përparimin në përmbushjet e objektivave, sa i përket aspektit cilësor dhe sasior të strategjive dhe planeve përkatëse, si dhe do të informojnë rregullisht Kryeministrin mbi zhvillimet në sektor.

Sa më sipër, grupi ndërministror i punës kryen funksionet e mëposhme<sup>10</sup>:

- Harton politikat dhe strategjitë për ndryshimet klimatike dhe kujdeset për përfshirjen e tyre në programet përkatëse sektoriale;

<sup>10</sup> Urdhër Kryeministri nr. 155, datë 25.04.2014 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit ndërministror të punës në fushën e ndryshimeve klimatike”, pika 3;

- Nxiti dhe koordinon bashkërendimin ndërinstitucional për zbatimin e strategjive dhe planeve kombëtare për ndryshimet klimatike në sektorët përkatës, si dhe informon rregullisht Kryeministrin për përparimet në këtë fushë;
- Jep kontribut në qëndrimet kombëtare që mban Republika e Shqipërisë gjatë pjesëmarrjes në Konferencën e Palëve të UNFCCC-së, në takimet e Bashkimit Evropian dhe forumet rajonale dhe ndërkombëtare;
- Identifikon mundësitë për të lehtësuar, nxitur, vlerësuar dhe sipas rastit, shpreh opinion për projektet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;
- Miraton programin e punës për vitin kalendarik dhe e rishikon atë në mënyrë periodike.  
Në pikën 5 të Urdhrit të Kryeministrit nr. 155, datë 25.04.2014, parashikohet që: “Grupi ndërministror i punës duhet të mbledhet jo më pak se dy herë në vit”. Megjithatë, pavarësisht këtij përcaktimi, grupi ndërministror i punës nuk ka zhvilluar mbledhje të rregullta dhe takimi i fundit i tij është mbajtur në datën 1 Mars 2023.


**Mungon krijimi i një sistemi specifik monitorimi dhe vlerësimi, i cili mundëson nxjerrjen e mësimave dhe rishikimin e veprimeve prioritare, duke bërë korrigjimet e nevojshme në NAP.**

Monitorimi konsiderohet si një nga shtatë fushat e suksesit të NAP. Ky veprim mundëson ndjekjen e progresit dhe zbatimit për veprimet prioritare dhe bërjen e korrigjimeve, në rast nevojë.

Sistemi kombëtar i MRV-së në Shqipëri ka për qëllim arritjen e objektivave kryesore të mëposhtme:

- Përfshirjen e grupeve kryesore të interesit në një sistem që mbështet zbatimin e shpejtë dhe me kosto efektive të masave për klimën.
- Garantimin e përmirësimit të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm të memories institucionale me ekipe ekspertësh afatgjatë të cilët mund të monitorojnë, raportojnë dhe verifikojnë të dhënat.
- Nxjerrjen/gjenerimin në kohë të dokumenteve kombëtare transparente dhe informuese që mbështesin kontributin e Shqipërisë në objektivat afatgjatë të Marrëveshjes së Parisit.

Infografik nr.6: Procesi i NAP



Burimi: NAP Global Network

Duke marrë në konsideratë faktin se NAP duhet të rishikohet çdo 8 vjet, gjetjet e dala nga procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mundësonin korrigjimet e nevojshme në procesin dhe/ose dokumentin e NAP-it, duke lidhur kështu procesin e rishikimit me procesin e monitorim-vlerësimit dhe duke e kthyer këtë proces në një mekanizëm efektiv me qëllim garantimin e qëndrueshmërisë dhe progresit në fushën e ndryshimeve klimatike.

Pavarësisht impaktit pozitiv që do të sillte krijimi i një sistemi specifik monitorimi dhe vlerësimi të NAP, në vendin tonë ky sistem mungon.

**Nuk ka një metodologji monitorimit dhe vlerësimit të miratuar nga ministri. Nuk është miratuar një udhëzues për monitorimin e mbështetur në rezultate.**

Monitorimi i mbështetur në rezultate në lidhje me klimën që synohet të krijohet në bazë të këtij veprimi prioritar, duhet të përfshijë 2 fusha:

- Monitorimin e progresit të efekteve të ndryshimeve klimatike (të ashtuquajturit tregues të efektit): Këta tregues do të bazohen në informacionet e marra nga sistemet ekzistuese ose të zhvilluara rishtazi të vlerësimit, si Sistemi i Monitorimit Mjedisor të Konsoliduar për Shqipërinë (CEMSA), si edhe nga monitorimi bregdetar, hidrologjik ose meteorologjik.
- Monitorimin e progresit dhe suksesit të veprimeve për përshtatjen (të ashtuquajturit tregues të kundërpërgjigjes): Zhvillimi i këtyre treguesve të kundërpërgjigjes do të bazohet kryesisht te treguesit e NAP-it, si edhe në tregues të përzgjedhur nga veprimet prioritare.

Sa kaq, procesi i MVR mbulon, si monitorimin e efekteve klimatike, ashtu edhe monitorimin e kundërpërgjigjes për një përshtatje të suksesshme. Me qëllim realizimin e objektivave të këtij veprimi prioritar duhet të hartohet dhe aprovohet një program monitorimi i integruar si dhe të vlerësohet rregullisht një paketë treguesish (të efektit dhe kundërpërgjigjes). Lidhur me këtë fakt, MTM nuk ka marrë asnjë masë për hartimin e metodologjive dhe miratimin e treguesve që do të përdoren për procesin e monitorimit.

**Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka monitoruar çdo vit progresin dhe suksesin e veprimeve prioritare të NAP.**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me GNPKNK duhet të vlerësojë çdo vit, përparimin e strategjive kombëtare dhe planeve që lidhen me ndryshimet klimatike. Megjithatë, pavarësisht këtij fakti, MTM nuk ka monitoruar në mënyrë periodike progresin e veprimeve prioritare. Prosesi i mbledhjes së të dhënave ka qenë problematik, për shkak të mungesës së raportimit dhe koordinimit ndërinstitucional në lidhje me projektet për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Nga viti 2019 e në vijim, MTM duhet të kishte gjeneruar çdo vit një progres raport lidhur me zbatueshmërinë e veprimeve prioritare dhe realizimin e objektivave të tyre. Mirëpo, i vetmi raport i progresit të NAP është ai i hartuar në vitin 2023, i cili është hartuar në bashkëpunim me UNDP dhe nuk ka fuqi juridike pasi nuk është miratuar.

Sa më sipër, projekti i PNUD: *“Avancimi i planifikimit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë nëpërmjet zhvillimit të një procesi të planifikimit kombëtar të përshtatjes”* do të asistoj MTM-në për ngritjen e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit, i cili do të asistoj për të vlerësuar rëndësinë e përgjithshme të këtyre projekteve/iniciativave, kontributin e tyre në arritjen e objektivave të përcaktuara, vlerën e shtuar dhe efektivitetin e kostos, mësimet e nxjerra dhe rekomandimet për të rritur efektivitetin.

Metodologjia e përdorur për përgatitjen e Raportit të Parë të Progresit u hartua përmes një rishikimi gjithëpërfshirës të literaturës, një procesi me pjesëmarrje të palëve të interesuara dhe mbledhjes së të dhënave të kryera në dy faza. U identifikuan kriteret për të karakterizuar statusin e zbatimit të masave të PKP-së, kategorizimin e tyre dhe mënyrën e vlerësimit të efektivitetit të tyre. Këto kriteret u bazuan në qasjen e ndërmarrë nga Grenada në raportin e saj të progresit të PKP-së.

- *Faza e parë* e mbledhjes së të dhënave u realizua nga takimet me palët e interesuara, veçanërisht me institucionet e identifikuara në NAP për zbatimin e masave të përzgjedhura.



- *Faza e dytë* e mbledhjes së të dhënave përfshiu anëtarët e GNPNK. Më 1 mars 2023 u mbajt workshopi konsultativ, ku morën pjesë 20 përfaqësues nga institucione të ndryshme qeveritare.

**Gjetje nga auditimi 4:** Grupi Ndërmnistror i Punës për Ndryshimet Klimatike nuk është mbledhur në mënyrë periodike sipas parashikimit të Urdhrit të Kryeministrit. GNPNK nuk ka zhvilluar mbledhje të rregullta dhe takimi i fundit i tij është mbajtur në datën 1 Mars 2023.

**Gjetje nga auditimi 5:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka krijuar një sistem specifik monitorimi dhe vlerësimi, i cili mundëson nxjerrjen e mësimave dhe rishikimin e veprimeve prioritare, duke bërë korrigjimet e nevojshme në Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike.

**Gjetje nga auditimi 6:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka miratuar një metodologji për procesin e monitorimit dhe vlerësimit dhe as treguesit e efektit, me qëllim vlerësimin e progresit ndaj ndryshimeve klimatike.

**Gjetje nga auditimi 7:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka monitoruar çdo vit progresin dhe suksesin e veprimeve prioritare të Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. Nga viti 2019 e në vijim MTM duhet të kishte gjeneruar çdo vit një progres raport lidhur me zbatueshmërinë e veprimeve prioritare dhe realizimin e objektivave të tyre. Mirëpo, i vetmi raport i progresit të Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike është ai i hartuar në vitin 2023, i cili është hartuar në bashkëpunim me UNDP dhe nuk ka fuqi juridike pasi nuk është miratuar.

#### **Konkluzione:**

2. Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike dhe Plani Kombëtar i Përshtatjes theksojnë rëndësinë e një sistemi efektiv monitorimi dhe vlerësimi (M&V). Një sistem i tillë shërben si një mjet instrumental për të dhënë palëve të interesuara, politikë-bërësve, sektorit privat dhe shoqërisë civile njohuritë e nevojshme rreth kontekstit lokal për vendimmarrje dhe planifikim të informuar. Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri efektiv monitorimi dhe vlerësimi për NAP në vendin tonë ka qenë një punë e gjerë, por jo shumë e thelluar me çështje specifike që lidhen me përshtatjen. Mungesa e protokolleve të monitorimit dhe vlerësimit, mungesa e metodologjive për mbarëvajtjen e procesit të monitorimit dhe vlerësimit dëshmojnë për një proces të cunguar dhe vështirëson vlerësimin e arritjeve aktuale të nismave të përshtatjes të zbatuara deri më sot.

**Rekomandim 4.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa dhe garantojë mbledhjen e grupit ndërmnistror të punës në mënyrë periodike, të paktën dy herë në vit.

**Në vazhdimësi**

**Rekomandim 5.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit. Procesi i monitorimit të kryhet çdo vit dhe mësimet e nxjerra prej tij të reflektohen në procesin dhe/ose dokumentin e Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike, me qëllim rritjen e efektivitetit të këtij akti ndaj ndryshimeve klimatike.

**Menjëherë**

**Rekomandim 6.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të miratojë një metodologji për procesin e monitorimit dhe vlerësimit dhe treguesit e efektit, me qëllim vlerësimin e progresit ndaj ndryshimeve klimatike.

**Menjëherë**

## 5.2 A ka luajtur MTM një rol proaktiv në përfitim të fondeve për ndryshimet klimatike?

### 5.2.1 A është krijuar një strukturë e dedikuar për nxitjen dhe përthithjen e financimeve klimatike?

#### Mekanizmat financiar kombëtar


Procesi i NAP u krijua për herë të parë në vitin 2010, në kuadër të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike. Ky proces synon t'u mundësojë veçanërisht vendeve në zhvillim, identifikimin e nevojave të tyre, me qëllim përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë ndaj ndryshimeve klimatike, si dhe hartimin dhe zbatimin e strategjive dhe programeve konkrete për të adresuar nevojat e konstatuara.

Procesi i NAP është i vazhdueshëm, progresiv, i drejtuar dhe përbëhet nga katër elementë:

1. Përgatitja e terrenit kombëtar dhe identifikimi i boshllëqeve;
2. Hartimi i kuadrit rregullator të nevojshëm;
3. Zbatimi i strategjive të hartuara; dhe
4. Raportimi, monitorimi dhe rishikimi i procesit të NAP.

Sa kaq, ky proces ka nevojë për burime financimi në të katër elementët e identifikuar më sipër dhe në të dyja fazat e tij, si në fazën përgatitore të hartimit të NAP ashtu edhe në fazën e zbatimit dhe implementimit të veprimeve të parashikuara me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Kjo sepse, të gjitha këto aktivitete kërkojnë kohë dhe burime, të cilat përkthehen kështu në kosto.

Infografik nr. 6: Fazat dhe elementët përbërës të procesit të NAP



Burim: Grupi i Auditimit

Lloji i burimit financiar dhe shuma e nevojshme për t'u alokuar për secilin nga aktivitetet, në zbatim të procesit të NAP, kategorizohen si më poshtë:

- Burimet financiare mund të jenë **kombëtare** ose **ndërkombëtare**;
- Financimi mund të kryhet me të ardhura **publike** ose **private**.

#### Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm financimin e veprimeve prioritare të NAP


Pavarësisht sa më sipër, fillimisht çdo element i procesit të NAP-it ka nevojë për financim nga burimet publike kombëtare. Për këtë qëllim, kërkohet angazhimi i burimeve njerëzore dhe financiare

për të koordinuar procesin dhe për të lehtësuar planifikimin e përshtatjes në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes. Financimi nëpërmjet fondeve publike për zbatimin e NAP, ka rëndësi edhe për shkak se shumë nga veprimet prioritare që duhet të ndërmerren konsiderohen *e mirë publike* dhe për rrjedhojë, ky lloji financimi u mundëson qeverive kontroll të shtuar mbi mënyrën se si ato shpërndajnë fondet për të përmbushur nevojat e prioritizuara.<sup>11</sup>

Sa më sipër, buxhetet kombëtare konsiderohen si burim kyç dhe esencial i burimeve financiare që do të përdoren për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Krahasuar me burimet e tjera, të ardhurat publike të alokuara nga Buxheti i Shtetit kanë potencialin për të siguruar një financim relativisht të parashikueshëm dhe sistematik për procesin e NAP, veçanërisht në terma afatmesëm dhe afatgjatë. Njëkohësisht, përdorimi i një buxheti të dedikuar për zbatimin e veprimeve prioritare tregon angazhimin dhe përkushtimin e vendit për të avancuar në përpjekjet e përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike. Ky angazhim i treguar, shërben si një impakt pozitiv dhe mund të ndihmojë në rritjen dhe tërheqjen e investimeve ndërkombëtare.

Përbërja kryesore e të ardhurave shtetërore përfshin grante, taksa dhe të ardhura jo tatimore. Ato unifikohen me skemën publike të llogarive për të gjitha institucionet qendrore, të qeverisë vendore dhe fondeve të posaçme. Sa kaq, ekzekutimi i buxhetit shtetëror për procesin e NAP nuk është në duart e një subjekti të vetëm. Mirëpo, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, e cila është përgjegjëse për koordinimin e këtij procesi, duhet të marrë masa të bashkërendojë nismën integruese gjithëpërfshirëse.<sup>12</sup>

Infografik nr. 7: Buxheti Kombëtar për Procesin e NAP



*Burim: Grupi i Auditimit*

Megjithatë, pavarësisht se buxheti publik konsiderohet si burimi financiar kryesor për procesin e NAP, në PBA-të e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për periudhën objekt auditimi nuk është parashikuar financimi i veprimeve prioritare të NAP. Pas analizimit të pyetësorëve të dërguar gjatë fazës së terrenit, grupi i auditimit konstatoi se MTM ka vendosur në dispozicion vetëm burime njerëzore lidhur me procesin e NAP. Pjesa më e madhe e financimit të klimës në Shqipëri është shumë e varur nga burimet financiare ndërkombëtare. Mungesa e një mekanizmi financiar kombëtar efektiv dhe të qëndrueshëm vështirëson zbatimin e veprimeve prioritare për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

<sup>11</sup> [napgn-en-2017-financing-nap-processes-contributing-to-the-achievement-of-ndc-goals.pdf](https://napglobalnetwork.org/wp-content/uploads/2017/11/napgn-en-2017-financing-nap-processes-contributing-to-the-achievement-of-ndc-goals.pdf), fq.21;

<sup>12</sup> <https://napglobalnetwork.org/wp-content/uploads/2023/11/napgn-al-2023-albania-nap-progress-report.pdf>, fq. 177;

## **Mungesa e zhvillimit të një kuadri strategjik për financimet klimatike**

Duke marrë në konsideratë faktin se procesi i NAP-it nuk është i lidhur zyrtarisht vetëm me një burim financimi, një sfidë kyçe për vendet është të përcaktojnë se si të kombinojnë më së miri këto burime për të mbuluar gamën e kostove në të dyja fazat e procesit të NAP, duke marrë në konsideratë kapacitetet dhe rrethanat kombëtare. Për këtë qëllim, kërkohet kombinimi efektiv ndërmjet përdorimit të fondeve ekzistuese, tërheqjes së investimeve shtesë dhe gjenerimit të burimeve të reja të financimit.

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Parisit<sup>13</sup> edhe vendi jonë ka hyrë në epokën e re të procesit të politikave klimatike ndërkombëtare. Zbutja e efekteve të ndryshimeve klimatike është thelbësore, për të garantuar përshtatjen me kosto të arsyeshme ekonomike, mjedisore dhe sociale, çka është kyçi për një vend jashtëzakonisht të cënueshëm si Shqipëria.<sup>14</sup>

Strategjia e Përgjithshme Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike dhe Plani<sup>15</sup> fokusohet në zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike. NAP-i kuptohet kryesisht, si një proces afatgjatë për të cilin ky dokument ofron elementet kuadër si: parimet, objektivat, treguesit, veprimet prioritare dhe elementet e procesit. Sa kaq, në planin e përshtatjes janë identifikuar 15 veprime prioritare.

Veprimet Prioritare të paraqitura në dokumentin e NAP-it shqiptar kanë nevojë për financim që të zbatohen. Duke qenë se efektet e ndryshimeve klimatike sa vijnë e po rriten me kalimin e viteve, dhe në mënyrë që të ndalohen ndryshimet e mëdha transformuese në sektorë, Shqipëria ka nevojë të kërkojë mbështetje financiare si afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë për t'iu përshtatur këtyre efekteve.

Për këtë arsye, në veprimin prioritar numër 3 të NAP parashikohet ***“Gatishmëria financiare për klimën – Zhvillimi i kapaciteteve për financimin dhe zbatimin e NAP-it në Shqipëri”***.<sup>16</sup> Financimi i qëndrueshëm dhe përdorimi me sukses i burimeve financiare për procesin e NAP ka rëndësi specifike. Për shkak të rëndësisë që paraqet, si dhe me qëllim që ky proces të jetë efektiv nevojitet zhvillimi i një kuadri strategjik për financimet klimatike. Përfitimet që do të sillte përpilimi i këtij dokumenti strategjik financiar janë:

- Aksesin në buxhetin publik dhe në burimet e mundshme ndërkombëtare;
- Një vlerësim paraprak të mundësive alternative të disponueshme për financimin klimatik; dhe
- Miratimin e një liste me alternativat prioritare të financimit për Shqipërinë.

Më konkretisht, qëllimi dhe përfitimet e zhvillimit të një kuadri strategjik për financimet klimatike evidentohen në infografikun si më poshtë vijon:

<sup>13</sup> New York, 22 prill 2016;

<sup>14</sup>[https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-strategjia-e-ndryshimeve-klimatike-dhe-planet-e-veprimit\\_qershor-2019\\_-1.pdf](https://turizmi.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/2.-strategjia-e-ndryshimeve-klimatike-dhe-planet-e-veprimit_qershor-2019_-1.pdf), fq. 3;

<sup>15</sup> Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit 2019;

<sup>16</sup> Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Veprimit 2019, fq. 179;

## Infografik nr. 8: Përfitimet e zhvillimit të një kuadri strategjik për financimet klimatike



### *Burim: Grupi i Auditimit*

Për sa më sipër, pavarësisht impaktit pozitiv që do të sillte përpilimi këtij dokumenti për qëndrueshmërinë afatgjatë të planifikimit të përshtatjes, MTM nuk ka marrë masa për hartimin e një kuadri strategjik për financimet klimatike me qëllim nxitjen dhe përthithjen e financimeve klimatike nga donatorët. Mungesa e këtij dokumenti ka pasuar edhe me mungesën e përcaktimit të objektivave konkret për nxitjen dhe përfitimet e fondeve. Këto mangësi kanë ndikuar negativisht në mungesën e evidentimit dhe përzgjedhjes së alternativave prioritare ndërkombëtare të financimit si dhe përmirësimin e aksesit për të marrë financim klimatik, si dhe në mbështetjen sistematike nëpërmjet burimeve kombëtare dhe rritjen e mundësisë së Shqipërisë për të aksesuar fondet klimatike ndërkombëtare.

### **Mungesa e krijimit të sektorit të financimit klimatik dhe mungesa e nxjerrjes së mësimeve për financimet klimatike**

Strategjia e Ndryshimeve Klimatike, në veprimin prioritar nr. 3 “*Gatishmëria financiare për klimën*” parashikon krijimin e një sektori të financimit të klimës, me qëllim ndërgjegjësimin dhe dhënien e informacioneve për mundësitë e financimit klimatik.<sup>17</sup> Pavarësisht se MTM duhet të merrte masa për krijimin e këtij sektori brenda 12 muajve (vitit 2020) nga hartimi i strategjisë, deri më tani ky sektor nuk është krijuar. Në Ministrinë e Mjedisit dhe Turizmit, Drejtoria përgjegjëse për ndryshimet klimatike është Drejtoria e Ndryshimeve Klimatike, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme për Zhvillimin e Mjedisit. Referuar organizimit të kësaj drejtorie dhe strukturës organizative të MTM-së nuk është krijuar një sektor i financimit klimatik, me qëllim nxjerrjen e mësimeve dhe kryerjen e analizave për optimizimin e përthithjes së fondeve dhe studimin e alternativave financiare më të mira për ndryshimet klimatike dhe zbatimin e NAP.

**Gjetje nga auditimi 8:** Në PBA-të e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për periudhën objekt auditimi nuk është parashikuar financimi i veprimeve prioritare të Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, për shkak të buxhetit të kufizuar ka vendosur në dispozicion vetëm burime njerëzore për zbatimin e veprimeve prioritare.

**Gjetje nga auditimi 9:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka hartuar një kuadër strategjik për financimet klimatike, me qëllim përcaktimin e objektivave dhe analizimin e alternativave më të mira për përfitimet e fondeve për Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe nxitjen e përfitimeve nga donatorët.

<sup>17</sup> Strategjia e Ndryshimeve Klimatike dhe Planet e Verimit 2019, fq. 187;

**Gjetje nga auditimi 10:** Në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit nuk është krijuar sektori i financimit klimatik. Referuar Strategjisë së Ndryshimeve Klimatike, ky sektor duhet të ishte krijuar që në vitin 2020, me qëllim kryerjen e analizave për nxjerrjen e mësimeve dhe novacionit për financimet klimatike.

**Konkluzione:**

3. Mangësitë e evidentuara më sipër, dëshmojnë për mungesën e fokusit të MTM-së në realizimin e veprimit prioritar nr. 3 “*Gatishmëria financiare për klimën – Zhvillimi i kapaciteteve për financimin dhe zbatimin e NAP-it në Shqipëri*”. Krijimi i sektorit të financimit klimatik do të mundësonte optimizimin e përthithjes së vazhdueshme për financim lidhur me klimën, dhe në veçanti për zbatimin e NAP-it. Kjo strukturë do të integronte financat e brendshme dhe jo të brendshme, do të vlerësonte alternativat e buxhetimit, duke nxjerrë kështu mësime për të ardhmen dhe rritur efektivitetin institucional në përfitimin e fondeve dhe zbatimin e veprimit prioritar nr. 3. Njëkohësisht, mungesa e përfshirjes në planifikimin buxhetor afatmesëm të veprimeve të parashikuara në NAP, sjell zbatim të ulët të masave që duhet të ndërmerren me qëllim përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe cenon impaktin pozitiv që do të sillte implementimi rigoroz i këtij plani.

**Rekomandim 8.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa që zbatimi i veprimeve prioritare të NAP të përfshihet në planifikimin buxhetor afatmesëm të saj.

**Në vazhdimësi**

**Rekomandim 9.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të hartojë një strategji për financimet klimatike, me qëllim përcaktimin e objektivave dhe analizimin e alternativave më të mira për përfitimin e fondeve për Planin Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe nxitjen e përfitimeve nga donatorët.

**Në vazhdimësi**

**Rekomandim 10.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të krijojë sektorin e financimit klimatik, si dhe të kryej analiza për nxjerrjen e mësimeve dhe përmirësimin e proceseve të punës, me qëllim nxitjen dhe përfitimin e fondeve për zbatimin e Planit Kombëtar të Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike.

**Në vazhdimësi**

## **5.2.2 Si ka qenë ecuria e fondeve të përthithura për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike?**

### **Fondi i mjedisit i cili duhet të mbështesë masat për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike nuk është krijuar**

Ligji për mbrojtjen e mjedisit ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Për të mbështetur dhe për të nxitur veprimtaritë për mbrojtjen e mjedisit krijohet Fondi i Mjedisit. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për burimin e të ardhurave, mënyrën e funksionimit dhe të përdorimit të Fondit të Mjedisit. Gjithashtu, fondi i mjedisit, në përputhje edhe me ligjin për ndryshimet klimatike do të përdoret për të mbështetur zbatimin e masave për zbutje dhe përshtatje, sipas kërkesave në mënyrë që të zbatohet prioritetet e dokumenteve politike kombëtare për ndryshimet klimatike.

### **Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar nuk është miratuar me VKM**

Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike” krahas kuadrit të masave lidhur me monitorimin, raportimin dhe verifikimin e shkarkimeve të gazeve serrë përcakton gjithashtu edhe angazhimet e Shqipërisë lidhur me financimet kombëtare dhe ndërkombëtare mbi ndryshimet klimatike.<sup>18</sup> Një ndër

<sup>18</sup> Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, neni 2 pika ç;

objektivat apo parimet kryesore sa i përket financimeve mbi ndryshimet klimatike është mbështetja në financime ndërkombëtare apo dypalëshe krahas buxhetit të shtetit.

Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar udhëheq procesin e përgatitjes së programit kombëtar për ndryshimet klimatike dhe i komunikon Fondit të Gjellbër për Klimën prioritetet kombëtare për të mundësuar financimin e projekteve për reduktimin e gazeve me efekt serrë dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike e cila është edhe fokusi kryesor i këtij auditimi. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar (AKP), struktura dhe funksionimi i tij përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Qasja ndaj Fondit të Gjellbër së Klimës sigurohet nëpërmjet Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar si institucioni ndërmjetës midis Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Gjellbër për Klimën.<sup>19</sup>

### **Nuk dihet me saktësi vlera e projekteve të financuara lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike**

Në Shqipëri përgjatë periudhës objekt auditimi janë duke u realizuar disa projekte lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike si më poshtë:

1. Projekti “Avancimi i planifikimit të Shqipërisë për përshtatjen afatmesme dhe afatgjatë nëpërmjet zhvillimit të një procesi të planifikimit kombëtar të përshtatjes i cili është në fazë zbatimi dhe zbatohet nga UNDP për periudhën korrik 2021 - dhjetor 2024 me vlerë 2,763,047.93 USD. UNDP iu përgjigj thirrjes nga Autoriteti i Përcaktuar Kombëtar për Fondin e Gjellbër të Klimës në vitin 2017.
2. Gjatë viteve 2020-2023 Shqipëria ka aplikuar pranë GCF (*Green Climate Fund*) për Projektin ALBadapt. GIZ iu përgjigj thirrjes së hapur nga Autoriteti i Përcaktuar Kombëtar (*National Designed Authority - NDA*) për Fondin e Gjellbër të Klimës për projekt-ide në kuadër të përgatitjes së programit kombëtar për GCF-në në vitin 2019. GIZ-it ju kërkua zyrtarisht nga AKP zhvillimi i projekt idesë për GCF-në, proces të cilin e ka mbështetur financiarisht qeveria gjermane për rreth 2.5 vjet. Në kuadër të këtij projekti, qeveria gjermane deri më sot ka financuar kryerjen e studimit të fizibilitetit dhe propozimit për fonde në vlerën e 1.7 milionë euro. Në total ky projekt do të ketë një financim total prej 35 milionë euro dhe një kohëzgjatje 6 vjeçare.
3. Ruajtja e biodiversitetit nëpërmjet menaxhimit efektiv dhe rritjes së elasticitetit ndaj ndryshimeve klimatike në zonat ekzistuese të mbrojtura të Rajonit Malor të Shqipërisë së Veriut”. projekt i zbatuar nga UNEP financuar nga *Global Environment Facility* (GEF) në vlerën 1,411,188 USD.

### *Projekte të tjera të cilat kanë të përfshirë komponent të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike*

GCF është vetëm një nga mekanizmat financiar të cilët kanë mbështetur zbatimin e NAP. Deri në këto momente projektet e financuara i gjeni të listuara si më poshtë:

1. Përmirësimi i NDC (National Determined Contribute)<sup>20</sup> ekzistuese, tetor 2020 – janar 2022, Vlera 257,162 USD
2. Sistemi i Matjes, Raportimit dhe Verifikimit të Ndryshimeve Klimatike të Shqipërisë, Emetimet dhe Zbutja, Nëntor 2022 – Nëntor 2024, Vlera 349,476 USD, në zbatim
3. “Forcimi i NDA dhe mbështetja e procesit të aksesit të drejtpërdrejtë për Shqipërinë” i cili zbatohet nga GIZ në zbatim, Vlera e projektit 475.725 euro.

Pra, edhe pse 3 projektet e mësipërme kanë të përfshirë komponent të përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, nuk dihet me saktësi se çfarë vlere prej totalit të tyre ka shkuar vetëm për përshtatjen.

<sup>19</sup> Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, neni 33, pika 2,3,4;

<sup>20</sup> National Determined Contribute ose Kontributi Kombëtar i Përcaktuar është dokumenti i kontributit kombëtar të synuar, në linjë me përpjekjet globale për reduktimin e shkarkimeve të gazeve me efekt serrë;



Ndryshe nga situata në venin tonë, në Maqedoninë e Veriut, nga auditimi i SAI-t të këtij vendi, siç tregohet edhe në figurën e mëposhtme ka rezultuar se fondet e alokuara nga organizmat dhe mekanizmat financiare ndërkombëtare në vitet 2018 dhe 2019 kanë qenë rreth 25.1 milionë USD.

Fig. nr. 3: Financimet nga organizmat ndërkombëtare mbi masat zbutëse ndaj ndryshimeve klimatike në Maqedoninë e Veriut



Burimi: Raport Auditimi Performance i SAI-t të Maqedonisë së Veriut, 2021, fq. 19

### **Organizmat dhe mekanizmat financiare ndërkombëtare**

Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike - UNFCCC (*The United Nations Framework Convention on Climate Change*) hyri në fuqi më 21 mars 1994. Sot, ajo ka një anëtarësim pothuajse universal. Atë e kanë ratifikuar 198 vende anembanë botës dhe të cilat quhen Palë në Konventë. Qëllimi kryesor i Konventës është parandalimi i ndërhyrjes "të rrezikshme" njerëzore në sistemin klimatik. Në vitin 1994, kur UNFCCC hyri në fuqi, kishte më pak prova shkencore sesa tani. UNFCCC huazoi një linjë shumë të rëndësishme nga një prej traktateve mjedisore shumëpalëshe më të suksesshme në histori (Protokolli i Montrealit, në 1987): ai i detyroi shtetet anëtare të vepronin në interes të sigurisë njerëzore edhe përballë pasigurisë shkencore.<sup>21</sup>

### **Protokolli i Kiotos**

U miratua më 11 dhjetor 1997. Për shkak të një procesi kompleks ratifikimi, ai hyri në fuqi më 16 shkurt 2005. Aktualisht, janë 192 Palë në Protokollin e Kiotos. Shkurtimisht, Protokollin e Kiotos operacionalizon Konventën Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike duke i angazhuar vendet dhe ekonomitë e industrializuara në tranzicion të kufizojnë dhe reduktojnë emetimet e gazeve serrë (GHG – *Greenhouse gases*) në përputhje me objektivat individuale të dakorduara. Vetë Konventa u kërkon atyre vendeve vetëm të miratojnë politika dhe masa për zbutjen dhe të raportojnë periodikisht. Protokollin e Kiotos bazohet në parimet dhe dispozitat e Konventës dhe ndjek strukturën e tij. Ai angazhon vetëm vendet e zhvilluara dhe u vendos atyre një barrë më të rëndë nën parimin e "përgjegjësisë dhe kapaciteteve përkatëse të përbashkëta por të ndryshme", sepse beson se ato janë kryesisht përgjegjëse për nivelet aktuale të larta të emetimeve të gazeve serrë në atmosferë.<sup>22</sup>

<sup>21</sup> <https://unfccc.int/process-and-meetings/what-is-the-united-nations-framework-convention-on-climate-change;>

<sup>22</sup> [https://unfccc.int/kyoto\\_protocol;](https://unfccc.int/kyoto_protocol;)

### *Marrëveshja e Parisit*

Është një traktat ndërkombëtar ligjërishit i detyrueshëm për ndryshimet klimatike. Ai u miratua nga 196 Palë në Konferencën e OKB-së për Ndryshimet Klimatike në Paris, Francë, më 12 dhjetor 2015. Ajo hyri në fuqi më 4 nëntor 2016. Qëllimi kryesor i saj është të mbajë “rritjen e temperaturës mesatare globale nën 2° C mbi nivelet para-industriale” dhe të vazhdojë përpjekjet “për të kufizuar rritjen e temperaturës në 1,5° C mbi nivelet para-industriale”. Megjithatë, në vitet e fundit, liderët botërorë kanë theksuar nevojën për të kufizuar ngrohjen globale në 1.5°C deri në fund të këtij shekulli. Kjo për shkak se Paneli Ndërqeveritar i OKB-së për Ndryshimet Klimatike tregon se kalimi i pragut 1.5°C rrezikon të japë ndikime shumë më të rënda të ndryshimeve klimatike, duke përfshirë thatësira më të shpeshta dhe të rënda, valë të nxehti dhe reshje shiu. Për të kufizuar ngrohjen globale në 1.5°C, emetimet e gazeve serrë duhet të arrijnë kulmin deri në vitin 2025 dhe të ulen me 43% deri në vitin 2030. Marrëveshja e Parisit është një pikë referimi në procesin shumëpalësh të ndryshimeve klimatike, sepse, për herë të parë, një marrëveshje detyruese i sjell të gjitha kombet së bashku për të luftuar ndryshimin e klimës dhe për t’iu përshtatur efekteve të saj.<sup>23</sup>

### *Financimi i klimës*

Financimi i klimës i referohet financimeve lokale, kombëtare ose ndërkombëtare të nxjerra nga burime financimi publike, private dhe alternative dhe synon të mbështesë veprimet zbutëse dhe përshtatëse që do të adresojnë ndryshimet klimatike. Konventa, Protokollin e Kiotos dhe Marrëveshja e Parisit bëjnë thirrje për ndihmë financiare nga Palët me më shumë burime financiare për ato që janë më pak të pajisura dhe më të cënueshme. Kontributi i vendeve në ndryshimet klimatike dhe kapaciteti i tyre për t’i parandaluar ato dhe për të përballuar pasojat e tyre ndryshojnë jashtëzakonisht shumë. Financimi i klimës është i nevojshëm për zbutjen, sepse kërkohen investime në shkallë të gjerë për të reduktuar ndjeshëm emetimet. Financimi i klimës është po aq i rëndësishëm edhe për përshtatjen, pasi nevojiten burime të konsiderueshme financiare për t’iu përshtatur efekteve negative dhe për të zvogëluar ndikimet e një klime në ndryshim.

Në përputhje me parimin e "përgjegjësisë dhe aftësive përkatëse të përbashkëta por të ndryshme" të përcaktuara në Konventë, Palët nga vendet e zhvilluara duhet të sigurojnë burime financiare për të ndihmuar Palët e vendeve në zhvillim në zbatimin e objektivave të UNFCCC. Marrëveshja e Parisit rikonfirmon detyrimet e vendeve të zhvilluara, ndërsa për herë të parë inkurajon edhe kontributet vullnetare nga Palët e tjera. Palët e vendeve të zhvilluara duhet gjithashtu të vazhdojnë të marrin drejtimin në mobilizimin e financave për klimën nga një shumëllojshmëri burimesh, instrumentesh dhe kanalesh, duke vënë në dukje rolin e rëndësishëm të fondeve publike, nëpërmjet një sërë veprimesh, duke përfshirë mbështetjen e strategjive të drejtuara nga vendi, dhe duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet e Palëve të vendeve në zhvillim. *Një mobilizim i tillë i financimit të klimës duhet të përfaqësojë një progres përtej përpjekjeve të mëparshme.*

Është e rëndësishme që të gjitha qeveritë dhe palët e interesuara të kuptojnë dhe vlerësojnë nevojat financiare të vendeve në zhvillim, si dhe të kuptojnë se si mund të mobilizohen këto burime financiare. Sigurimi i burimeve duhet gjithashtu të synojë të arrijë një ekuilibër midis përshtatjes dhe zbutjes. Në përgjithësi, përpjekjet sipas Marrëveshjes së Parisit udhëhiqen nga qëllimi i saj për t’i bërë flukset financiare në përputhje me një rrugë drejt emetimeve të ulëta të gazeve serrë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ndaj klimës. Vlerësimi i progresit në ofrimin dhe mobilizimin e mbështetjes është gjithashtu pjesë e matjes globale sipas Marrëveshjes. Marrëveshja e Parisit gjithashtu vë theksin në transparencën dhe parashikueshmërinë e zgjeruar të mbështetjes financiare.<sup>24</sup>

### *Mekanizmat financiarë ndërkombëtarë*

Për të lehtësuar sigurimin e financimit të klimës, Konventa krijoi një mekanizëm financiar për të siguruar burime financiare për palët e vendeve në zhvillim. Mekanizmi financiar i shërben gjithashtu Protokollit të Kiotos dhe Marrëveshjes së Parisit. Konventa thotë se funksionimi i mekanizmit

<sup>23</sup> <https://unfccc.int/process-and-meetings/the-paris-agreement>;

<sup>24</sup> <https://unfccc.int/topics/introduction-to-climate-finance>;

financiar mund t'i besohet një ose më shumë subjekteve ndërkombëtare ekzistuese. Fondi Global i Mjedisit (GEF – *Global Environment Facility*) ka shërbyer si një ent operativ i mekanizmit financiar që nga hyrja në fuqi e Konventës në 1994. Në vitin 2010, Palët themeluan Fondin e Gjellbër Klimatik (GCF – *Green Climate Fund*) dhe në 2011 e caktuan gjithashtu si një subjekti operativ i mekanizmit financiar. Mekanizmi financiar i përgjigjet COP-it<sup>25</sup>, i cili vendos për politikën, prioritetet e programit dhe kriteret e pranueshmërisë për financim. Përveç dhënies së udhëzimeve për GEF-in dhe GCF-në, Palët kanë krijuar dy fonde speciale - Fondin Special për Ndryshimet Klimatike (SCCF - *Special Climate Change Fund*) dhe Fondin e Vendeve më pak të Zhvilluara (LDCF - *Least Developed Countries Fund*), të dy të menaxhuara nga GEF - dhe Fondi i Përshtatjes (AF - *Adaptation Fund*) themeluar sipas Protokollit të Kiotos në 2001. Në Konferencën e Parisit për Ndryshimet Klimatike në 2015, Palët ranë dakord që entitetet operative të mekanizmit financiar GCF, GEF si dhe SCCF e LDCF do t'i shërbejnë Marrëveshjes së Parisit. Në lidhje me Fondin e Përshtatjes që i shërben Marrëveshjes së Parisit, negociatat janë duke u zhvilluar në Grupin Ad hoc të Punës për Marrëveshjen e Parisit.<sup>26</sup>

GEF ka 186 vende anëtare. Vendet anëtare të GEF referohen si pjesëmarrës. Në terma të përgjithshëm, në GEF ka pjesëmarrës nga vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim. Ato përfaqësohen në Këshillin e GEF-it nga 32 zona elektorale (14 për vendet e zhvilluara, 16 për vendet në zhvillim dhe 2 për ekonomitë në tranzicion) secila me një anëtar të Këshillit dhe një anëtar zëvendësues të Këshillit. Përfaqësuesit e të gjitha vendeve anëtare takohen çdo katër vjet gjatë Asamblesë së GEF.<sup>27</sup> GEF ka disa role kyçe për të luajtur sipas Marrëveshjes së Parisit. GEF shërben si pjesë e mekanizmit financiar të Marrëveshjes, e cila gjithashtu krijoi një proces për të siguruar që të gjitha veprimet mbi ndryshimet klimatike të jenë plotësisht transparente me një mekanizëm për të ndihmuar vendet për të përmbushur këtë qëllim. Strategjia e GEF-it për zbutjen e ndryshimeve klimatike, e cila financohet përmes Fondit të Mirëbesimit të GEF, mbështet vendet në zhvillim ndërsa ato bëjnë ndryshime transformuese drejt emetimeve neto zero të gazeve serrë dhe rrugëve të zhvillimit elastik ndaj klimës me dy shtylla themelore:

- Promovimi i inovacionit, zhvillimit dhe transferimit të teknologjisë si dhe mundësimi i politikave për opsionet e zbutjes me ndikime sistematike, në katër pika kyçe hyrëse:
  - Përshpejtimi i përdorimit eficient të energjisë dhe materialeve;
  - Mundësimi i kalimit në sistemet energjetikë të dekarbonizuara;
  - Rritja e lëvizshmërisë së njerëzve dhe mallrave me emetim zero;
  - Promovimi i zgjedhjeve të bazuara në natyrë me potencial të lartë zbutës.
- Nxitja e kushteve për integrimin e shqetësimeve të zbutjes në strategjitë e zhvillimit të qëndrueshëm:
  - Mbështetja e nevojave për ndërtimin e kapaciteteve për transparencë sipas Marrëveshjes së Parisit përmes Iniciativës për ngritjen e kapaciteteve për transparencë;
  - Mbështetja e detyrimeve përkatëse të Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe aktiviteteve mundësuese.

*Fondi Special i Ndryshimeve Klimatike (SCCF)* u themelua në 2001 për të financuar projekte lidhur me përshtatjen, transferimin e teknologjisë dhe ngritjen e kapaciteteve, energjinë, transportin, industrinë, bujqësinë, pyjet dhe menaxhimin e mbetjeve. Ky fond duhet të plotësojë mekanizmat e tjerë financues për zbatimin e Konventës. Funksionimi i i SCFF i është besuar Fondit Global të Mjedisit (GEF). Në vitin 2004, Këshilli i GEF miratoi një dokument programimi i cili ofron bazën operative për financimin e aktiviteteve në kuadër të SCCF.

<sup>25</sup> COP – Conference of Parties. COP është organi suprem vendimmarrës i UNFCCC;

<sup>26</sup> <https://unfccc.int/topics/introduction-to-climate-finance>;

<sup>27</sup> <https://www.thegef.org/projects-operations/participant-countries>;

*Fondi i vendeve më pak të zhvilluara (LDCF)* u krijua për të mbështetur një program pune për të ndihmuar palët e vendeve më pak të zhvilluara të kryejnë, ndër të tjera, përgatitjen dhe zbatimin e programeve kombëtare të adaptimit të veprimit (NAPA). Fondi Global i Mjedisit (GEF), është përgjegjës gjithashtu edhe për operimin e LDCF. Konferenca e Palëve (COP), në sesionin e saj të njëmbëdhjetë, ra dakord mbi dispozitat për të funksionalizuar LDCF dhe për të mbështetur zbatimin e NAPA-ve, duke ofruar udhëzime në lidhje me fushat prioritare dhe dispozita për financimin me kosto të plotë.<sup>28</sup>

**Gjetje nga auditimi 11:** Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe ligji për ndryshimet klimatike parashikojnë krijimin e fondit të mjedisit. Ky fond krahas nxitjes së veprimtarisë për mbrojtjen e mjedisit ka si qëllim edhe zbatimin e masave për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Edhe pse Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka propozuar krijimin e fondit të mjedisit ai nuk është miratuar me VKM.

**Gjetje nga auditimi 12:** Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar nuk është krijuar me VKM. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, duhet të miratojë vendimin për krijimin e Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar të Mekanizmit të Zhvillimit të Pastër në kuadër të Protokollit të Kiotos. Gjithashtu nuk ka një dokument të miratuar i cili sanksionon procedurën për aplikim për fonde e projekte lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Nuk ka një afat të përcaktuar për kohëzgjatjen e miratimit të projektit të miratuar me akt të posaçëm. Nisur nga procedurat për miratimin e projekteve të mësipërme procedura nga shkrimi i “*Concept note*” (projekt propozimi) për projektin “Albadapt” deri në fillimin e zbatimit të tij ka zgjatur rreth 4 vite.

**Gjetje nga auditimi 13:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka një regjistër me të dhëna mbi aplikimet për projekte, fondet e alokuara, aktivitetet e parashikuara dhe ato të realizuara, shkëmbimin e informacioneve me ministrinë e linjës dhe organizmat ndërkombëtare.

**Gjetje nga auditimi 14:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka të dhëna të sakta e të detajuara mbi vlerën e fondeve apo projekteve të financuara përgjatë periudhës 2020-2023 lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Pavarësisht se përgjatë kësaj periudhe janë përfituar fonde dhe projekte lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike mungesa e monitorimit të detajuar të tyre ka sjellë që Ministria e Turizmit dhe Mjedisit mos të ketë informacione se sa fonde shkojnë për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike për secilin vit. Gjithashtu, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit nuk ka mbështetur me fonde publike projekte apo aktivitete mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike dhe nuk ka informacion nëse buxheti i shtetit ka mbështetur projekte apo aktivitete mbi përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

#### **Konkluzione:**

4. Fondi i mjedisit është konceptuar si një mekanizëm financiar i cili do të kontribuojë në marrjen e masave për të reduktuar dhe minimizuar efektet negative në mjedis nga aktivitetet e njeriut. Mos krijimi i fondit të mjedisit cenon veprimtarinë për mbrojtjen e mjedisit dhe nuk mundëson zbatimin e masave dhe aktiviteteve për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
5. Autoriteti Kombëtar i Përcaktuar është parashikuar për të qenë ura lidhëse midis qeverisë shqiptare dhe organizmave ndërkombëtare që do të mbështesin financiarisht Shqipërinë në projekte e studime lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike. Mungesa e krijimit të tij me VKM ashtu siç e parashikon ligji si dhe mungesa e një dokumenti formal apo akti nën ligjor mbi procedurën e aplikimit për projekte në mekanizmat financiare ndërkombëtare nuk lehtëson aspak aplikimin dhe përthithjen e fondeve të tilla.
6. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit duke mos pasur të dhëna të sakta e të detajuara mbi fondet e alokuara për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, aktivitetet e parashikuara dhe ato të

<sup>28</sup> <https://unfccc.int/process-and-meetings/bodies/funds-and-financial-entities/least-developed-countries-ldc-fund>.

realizuara e ka thajse të pamundur për të monitoruar treguesit kryesorë të këtyre projekteve si dhe për të vlerësuar ecurinë ndër vite të tyre.

**Rekomandim 11.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të ri kërkojë miratimin e fondit të mjedisit si një mekanizëm kyç financiar në mbështetjen e aktiviteteve lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

**Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025**

**Rekomandim 12.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të propozojë në Këshillin e ministrave miratimin me VKM të Autoritetit Kombëtar të Përcaktuar duke përcaktuar qartë procedurën për aplikim për fonde e projekte lidhur me përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

**Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2025**

**Rekomandim 13.1:** Ministria e Turizmit dhe Mjedisit të marrë masa për të siguruar në vazhdimësi të dhëna të sakta e të detajuara mbi aplikimet për projekte, fondet e alokuara, aktivitetet e parashikuara dhe ato të realizuara si dhe shkëmbimin e informacioneve me ministrinë e linjës dhe organizmat ndërkombëtare.

**Në vazhdimësi**